



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 130 Akti

Nr. 180.Vendimi
Tiranë, më 18.07.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj
Valbona Sanxhaktari
Xhensila Pine

Kryesues
Anëtare
Relatore

në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kiljstra, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në datën 11.7.2019, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, zhvilloi seancën mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Z. Ilir Mustafaj, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoji subjektin e rivlerësimit Z. Ilir Mustafaj, dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N :

1. Z. Ilir Mustafaj është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, u shortua në datën 15.5.2018 me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Lulzim Hamitaj dhe Genta Tafa Bungo (relatore).

3. Në datën 24.5.2018, në përputhje me Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit” relatorja e çështjes, komisionere Genta Tafa Bungo, ka paraqitur dorëheqjen nga subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj.

4. Kjo kërkesë është shqyrtuar nga një trup tjetër gjykues, i shortuar, i cili ka vendosur pranimin e kërkesës së relatores së çështjes dhe kalimin e kësaj çështjeje anëtarit zëvendësues caktuar me short komisionere Xhensila Pine.

5. Pas zëvendësimit të relatorit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si “ILDKPKI”) sipas neneve 31–33, të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si “DSIK”) sipas neneve 34 – 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë (në vijim referuar si “KLD”) sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

6. Trupi gjykues me vendimin nr. 1 vendosi të fillojë hetimin administrativ e të caktojë me mirëkuptim kryesues z. Lulzim Hamitaj. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan mosqënien në konflikt interesi.

7. Në datën 7.9.2018, subjekti i rivlerësimit u njoh me përbërjen e trupit gjykues dhe me të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Ai deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

8. Në datën 7.12 .2018, trupi gjykues i dërgoi pyetësor subjektit të rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, duke e njoftuar se koha për kthimin e përgjigjeve në datën 17.12.2018. Me *e-mai-lin* e datës 12.10.2018 subjekti i rivlerësimit, për arsye objektive kërkoi kohë më të gjatë për kthimin e përgjigjeve.

9. Në përgjigje të kësaj kërkesë trupi gjykues, duke marrë në konsideratë arsyet objektive të paraqitura nga subjekti, vendosi të shtyjë afatin e dhënies së përgjigjeve dhe me *e-mail-in* e datës 10.12.2018 njoftoi subjektin se koha e dhënies së shpjegimeve ishte shtyrë deri në datën 31.12. 2018.

10. Në datën 13.5.2019, trupi gjykues vendosi bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, të përfundojë hetimin për subjektin e rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, pasi provat për këtë kriter, kishin arritur nivelin e provueshmërisë.

11. Për sa më sipër, trupi gjykues, me *e-mail-in* e datës 13.5.2019, (i)njoftoi subjektin e rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 të Aneksit të Kushtetutës; (ii) njoftoi subjektin e rivlerësimit me të drejtën për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) njoftoi subjektin e rivlerësimit, me të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.

12. Në datën 14. 5.2019, subjekti i rivlerësimit dërgoi me anë të postës elektronike kërkesën e tij për përfshirjen edhe të dy komponentëve të tjerë, atë të figurës dhe të vlerësimit profesional, për të si subjekt rivlerësimi, si dhe për shtyrjen e afatit për të paraqitur prova dhe shpjegime, pasi koha me 10 ditë kalendarike ishte e pamjaftueshme për të paraqitur mbrojtjen e tij, duke kërkuar një kohë të arsyeshme, mundësisht 30 ditë kalendarike.

13. Pasi u njoh me kërkesën e sjellë nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues, vendosi:

- Bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, të mos pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, për përfshirjen edhe të dy komponentëve të tjerë, atë të figurës dhe të vlerësimit profesional pasi provat e administruara, për pasurinë, kishin arritur nivelin e provueshmërisë

- Të pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për shtyrje afati, duke caktuar si afat të ri për paraqitjen e provave dhe shpjegimeve, datën 10.6.2019.

14.z. Ilir Mustafaj, brenda afatit të përcaktuar nga trupi gjykues paraqiti provat dhe shpjegimet e tij. Trupi gjykues, mbasi administroi e analizoi provat e subjektit me vendimin nr. 3, datë 12.6.2019, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016. Përmes postës elektronike subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 14.6.2019, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, kati 0, salla B, Tiranë.

15. Në datën 13.6.2019, subjekti rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, kërkoi shtyrjen e seancës dëgjimore, për një datë tjetër, pasi në datën 14.6.2019, ora 12:00, kishte planifikuar një seancë gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, dhe koha një ditore për seancën dëgjimore ishte e pamjaftueshme për t'u përgatitur për këtë seancë. Gjithashtu, subjekti kërkoi thirrjen si dëshmitar të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., si dhe rikërkoji ti bëhen të njohura paraprakisht rezultatet e hetimit edhe për të dy kriteret e tjera të vlerësimit, sepse ato harmonizonin linjën e mbrojtjes me vlerësimin rreth kriterit të pasurisë.

16. Trupi gjykues, pasi u njoh me këtë kërkesë të sjellë nga subjekti i rivlerësimit, vendosi dhe njoftoi subjektin e rivlerësimit, për sa më poshtë vijon:

- Në lidhje me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për thirrjen e një dëshmitari, konkretisht të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., trupi gjykues vendosi të mos pranojë këtë kërkesë të subjektit, duke rezervuar të drejtën e arsyetimit në vendimin përfundimtar për këtë kërkesë.
- Në lidhje me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për shtyrje të seancën dëgjimore, duke vlerësuar sa ai parashitroi, vendosi që seanca dëgjimore të shtyhej në të njëjtën datë (14.6.2019) nga ora e planifikuar 12:00 në orën 17:00 të pasdites, duke i dhënë mundësi subjektit të kryente seancën gjyqësore planifikuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.
- Në lidhje me kërkesën për të pasur kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur për seancë trupi gjykues njoftoi subjektin se koha 30 ditore dhënë atij për përgatitjen e shpjegimeve dhe provave ishte e mjaftueshme, edhe për seancën dëgjimore si hap i fundit i këtij procesi.
- Në lidhje me kërkesën e tij për t'u njohur me rezultatet e hetimit edhe për dy kriteret e tjera të vlerësimit, trupi gjykues i ribëri me dije subjektit të rivlerësimit se deri në këtë fazë të hetimit administrativ ishte vendosur të mbyllej hetimi, për te si subjekt rivlerësimi, vetëm për kriterin e pasurisë sipas pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

17. Në datën 14.6.2019, subjekti i rivlerësimit u paraqit në seancën dëgjimore dhe depozitoi pranë trupit gjykues një kërkesë për përjashtimin e relatores të çështjes, znj. Xhensila Pine, bazuar në nenet 4.6 dhe 55, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 1.2 dhe 34.1, të ligjit nr. 449/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nenit 72.6 të Kodit të Procedurës Civile sipas rrethanave konkrete, arsye njëanshmërie, si më poshtë:

- *ka refuzuar kërkesën për thirrjen e një dëshmitari, konkretisht, përfaqësuesit ligjor të shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k;*
- *në kundërshtim me nenin 231, të Kodit të Procedurës Civile, relatorja ka përmbysur standardin e procesit të të provuarit në një gjykim civil/administrativ sepse ka tentuar të*

kundërshtojë nëpërmjet pyetjes së dëshmitarit provën më shkresë të cilën ligji e kërkon për vlefshmërinë e veprimit juridik apo provimin e tij;

- *ka paragjykuar procedurën e hetimit rivlerësues të ditëve të fundit lidhur me përvetësimin e parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar me qëllim drejtpeshimin ligjor të pozicionit;*
- *i ka ngarkuar barrën e provës subjektivit të rivlerësimit për një kriter, atë të pasurisë, duke u treguar e njëanshme dhe duke e paragjykuar në këtë mënyrë çështjen e tij. Gjuha e përdorur në raportin e dërguar, e cila nuk përmban edhe vlerësimet e dy shtyllave e tjera të rivlerësimit, është gjuhë që shpreh veçse konkluzionet e arritura paraprakisht.*

18. Trupi gjykues sipas parashikimeve ligjore, vendosi ndërprerjen e seancës dëgjimore, me qëllim që një trup tjetër gjykues të shqyrtonte kërkesën e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit.

19. Mbledhja e Komisionit, me vendimin nr. ***, datë 14.6.2019, vendosi ngritjen e trupit gjykues për shqyrtimin e kërkesës së z. Ilir Mustafaj.

20. Trupi gjykues i miratuar me vendimin nr. ***, datë 14.6.2019 të mbledhjes së Komisionit, në mbështetje të pikës 3, të nenit 27, të pikës 6, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, neni 30, i Kodit të Procedurës Administrative dhe Rregullores “Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, pasi mori në shqyrtim kërkesën provat faktet e rrethanat arsyei se:

*“Në lidhje me pretendimin për mosthirrjen e një dëshmitari, konkretisht përfaqësuesit ligjor të shoqërisë ndërtuese “***” sh.p.k., ky trup gjykues, pa vlerësuar në themel çështjet që nuk janë në juridiksion të tij, çmon se në rastin konkret janë kryer në mënyrë ezauruese të gjitha veprimet e duhura hetimore në funksion të kërkesës së subjektivit të rivlerësimit. Sipas provave të administruara nga ana jonë, konstatojmë se kjo shoqëri është thërritur dy herë në Komision për të dhënë dëshmi, shpjegime dhe informacione. Administratori i kësaj shoqërie herën e parë ka dërguar një punonjëse të shoqërisë që kishte 9 muaj punë dhe pas rithirrjes nga Komisioni ka dërguar përfaqësuesen e saj, financieren e shoqërisë, pranë Komisionit për të dhënë shpjegime për rrethanat e sipërcituara nëpërmjet autorizimit të firmosur nga vete ai. Vlerësimi që trupi gjykues ka bërë në këtë rast për mosthirrjen e administratorit është bërë në vlerësim të hapave hetimore, komunikimit elektronik të trupit me administratorin dhe të dokumentacionit që përfaqësuesja e shoqërisë ka vënë në dispozicion të saj. Për sa më sipër nuk ekzistojnë elementë anshmërie nga relatori dhe trupi gjykues.*

Lidhur me pretendimin se në kundërshtim me neni 231 të Kodit të Procedurës Civile relatorja ka përmbysur standardin e procesit të të provuarit në një gjykim civil/administrativ sepse ka tentuar të kundërshtojë nëpërmjet pyetjes së dëshmitarit provën më shkresë, të cilën ligji e kërkon për vlefshmërinë e veprimit juridik apo provimin e tij, trupi gjykues vlerëson, se është në vlerësim të trupit gjykues kryerja e një veprimi hetimor në funksion të një rezultati hetimi sa më të drejtë dhe të gjithanshëm. Nuk përbën elementë anshmërie si nga ana subjektive ashtu edhe objektive thirrja e një dëshmitari apo kryerja e një veprimi tjetër hetimor. Po kështu dhe analiza që ky trup i bën provave të administruara gjatë hetimit nuk është shkak për anshmëri, por përbën një reflektim të provave të administruara në barrën e provës së dërguar.

Në lidhje me pretendimin që subjekti pretendon, paragjykim që lidhet me procedurën e hetimit rivlerësues të ditëve të fundit lidhur me përvetësimin e parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar me qëllim drejtpeshimin ligjor të pozicionit, duke marrë në konsideratë dokumentacionin e vënë në dispozicion nga ana e relatores së çështjes, çmon se ky pretendim është i pabazuar pasi elementi kohë i pretenduar nuk është argument provues për mosanalizimin e informacionit të dërguar nga trupi gjykues.

Në lidhje me pretendimin lidhur me faktin se gjuha e përdorur në raportin e dërguar, e cila nuk përmban edhe vlerësimet e dy shtyllave e tjera të rivlerësimit, është gjuhë që shpreh veçse

konkluzionet e arritura paraprakisht, vlerësojmë se është e pabazuar pasi ky dokument rezulton konform nenit 52, të ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me pretendimin për mospërfshirjen e dy kriterëve të tjerë të vlerësimit trupi gjykues vlerëson se ka qenë trupi gjykues që ka vendosur ta përfundojë hetimin për kriterin e pasurisë pasi provat për këtë kriter janë çmuar nga ky trup të plota. Trupi gjykues çmon se për asnjë rast, ushtrimi i detyrës funksionale dhe/ose mënyra e interpretimit dhe zbatimit të legjislacionit në fuqi, nuk përbën paragjykim dhe cenim të paanësisë së trupit gjykues, dhe për rrjedhojë nuk mund të përbëjë shkak për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues.

Në çdo rast, si kur hetimi mbyllet me një komponent ose me tre, hetimi administrativ mund të rihapet, nëse subjekti sjell prova të mjaftueshme për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Trupi gjykues çmon se në këtë rast nuk ekzistojnë arsye legjitime për të dyshuar se kemi të bëjmë me njëanshmëri pasi dyshimet e ngritura nuk janë objektivist të justifikueshëm.

Parimet e paanësisë dhe objektivitetit në gjykim, të parashikuara në nenet 6 dhe 39, të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, nenit 42, të Kushtetutës nuk janë cenuar në këtë rast konkret nga relatorja e çështjes.”

21. Në përfundim, bazuar ne arsyetimin e mësipërm, u vendos të rrëzohet kërkesa e subjektit të rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, për përjashtimin e relatores së çështjes, znj. Xhensile Pine, si e pabazuar në ligj dhe në prova dhe subjekti u njoftua për këtë vendim dhe gjithë dokumentacionin.

22. Në datën 8.7.2019, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues me vendimin nr. 4, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, në vijimin e seancës dëgjimore, e cila do të zhvillohej në datën 11.7.2019, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i 2-të, Tiranë.

23. Gjatë seancës dëgjimore subjekti paraqiti kërkesën e tij në lidhje me shkeljen e të drejtës së tij për zhvillimin e një procesi të rregull ligjor, bazuar në sa ka parashtruar në kërkesën e tij për përjashtimin e relatores, si dhe në sa në *e-mail-in* dërguar trupës së shqyrtimit të përjashtimit të saj me përmbajtjen e të cilit relatorja ishte treguar paragjyqese, me shprehjen:

“Lidhur me ankesën e subjektit se dokumentacionet dhe shpjegimet e dërguara prej tij nuk janë lexuar dhe administruar, do të dëshiroja t’ju vija në dijeni se ne kemi punuar shumë dhe e kemi analizuar të gjithë dokumentacionin e dërguar nga subjekti dhe në ditën e seancës dëgjimore dokumentacioni ishte finalizuar së studiuar nga trupa por kjo nuk ka sjellë asnjë ndryshim në rezultatet e hetimit, siç pretendohet nga ana e subjektit të rivlerësimit”

24. Në datën 17 korrik 2019, vëzhguesi ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra, i paraqiti trupit gjykues një mendim/opinion për subjektin e rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, sipas të cilit trupi gjykues duhet të arsyetojë në vendim për të gjithë argumentet e subjektit për procesin e rregullt ligjor, si dhe për pretendimin e subjektit për mospërfshirjen e zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor sipas standardeve Kushtetuese dhe Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, bazuar në sa relatorja ka parashtruar në *e-mail-in* e drejtuar trupit gjykues së formuar për të shqyrtuar përjashtimin e saj.

24.1 Ky mendim i vëzhguesit ndërkombëtar u pranua nga trupi gjykues, i cili mori masa për zbatimin e tij, sipas parashikimeve të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016.

25. Trupi gjykues, në vijim të mendimit të sjellë nga vëzhguesi ndërkombëtar në lidhje me kërkesën e paraqitur në seancë nga subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, arsyetoi se:

26. Në lidhje me pretendimin e subjektit për sigurimin e zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor sipas standardeve Kushtetuese dhe Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, për sa i përket kërkesave të referuara për përjashtimin e relatores së trupit gjykues në seancën e datës 14.6.2019, ato kanë qenë objekt shqyrtimi nga një trup tjetër gjykues në mbështetje të pikës 3, të nenit 27, të pikës 6, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, neni 30, i Kodit të Procedurës Administrative

si dhe Rregullores “Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, arsyetuar në pikën 20.1 të këtij vendimi.

27. Në lidhje me sa subjekti ka referuar në seancën e datës 11.7.2019, për *e-mail-in* e dërguar nga relatorja trupit gjykues së shqyrtimit të përjashtimit, arsyetohet sa vijon:

27.1 Në datën 13.5.2019, trupi gjykues bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, vendosi të përfundojë hetimin për subjektin e rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, pasi provat kishin arritur nivelin e provueshmërisë vetëm për këtë kriter.

27.2 Trupi gjykues i dërgoi subjektit rezultatet e hetimit duke i dhënë mundësinë e dhënies së provave dhe të shpjegimeve për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit për këtë kriter.

27.3 Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur provat dhe shpjegimet e kërkuara nga Komisioni, dhe pas analizimit të tyre ato nuk kanë arritur të përmbysin barrën e provës për kriterin e pasurisë, duke mos sjellë një ndryshim domethënës *që do të passillte rihapjen e shqyrtimit edhe për dy komponentët e tjerë të rivlerësimit*.

27.4 Për sa më sipër është parashtruar edhe në *e-mail-in* që relatorja i ka dërguar trupit gjykues që shqyrtonte kërkesën e subjektit për përjashtimin e saj. Kjo në asnjë rast nuk përbën një paragjykim pasi është pikërisht seanca dëgjimore publike e cila do të zhvillohej për subjektin garancia e parashikuar nga ligji në të cilën, subjekti i rivlerësimit ushtron të drejtën për t’u dëgjuar nëpërmjet parashtrimit të argumenteve, opinioneve apo diskutimeve ligjore të tij mbi rezultatet e arritura prej Komisionit, në këndvështrim edhe të provave të reja të paraqitura prej tij, si edhe mundësinë ligjore për të paraqitur në një fazë finale ato prova që nuk janë mundur të paraqiten gjatë fazës së hetimit administrativ.

27.5 Në çdo rast, edhe nëse përgjigjia e relatores nëpërmjet e-mailit të sipërcituar, ku ka shprehur mosndryshimin e rezultateve pas paraqitjes së prapsimeve nga subjekti, do të vlerësohej e papërshtatshme në mënyrë dhe kohë, duhet theksuar se kjo rrethanë nuk ka përbërë dhe nuk mund të përbente një paragjykim të subjektit në lidhje me vendimmarrjen përfundimtare, për dy arsye. Nga njëra anë vlerësimi dhe konkludimi nga trupi gjykues mbi përfundimin e hetimeve vetëm për një kriter, është kryer dhe vendosur në mënyrë kolegjiale dhe unanime. Kështu që, edhe nëse do të hipotizohet një paragjykim i mundëshëm nga ana e relatores, ai do të ishte kompensuar dhe tejkalar/kapërxyer nga vlerësimi dhe votimi ndryshe i anëtarëve të tjerë të trupës.

27.6 Nga ana tjetër duhet pasur parasysh fakti se, edhe në një moment të dytë, - pas shqyrtimit të prapsimeve, shpjegimeve, dokumenteve shoqëruese dhe përgjigjeve e argumentimeve të subjektit (gjate hetimit dhe në seancë dëgjimore), - ishte gjithmonë mundësia për të rihapur hetimet, duke konkluduar rivlerësimin mbi të tre kriteret. Fakti që kjo rrethanë nuk është verifikuar në rastin konkret, nuk varet nga ndonjë ndikim paragjykimi, por thjesht nga shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të administruar, i cili i plotësonte kushtet e parashikuara në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

27.7 Vendimi mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë, nuk përbën në asnjë rast gjë të gjykuar për kriterin e figurës dhe atë të vlerësimit profesional.

SEANCA DËGJIMORE

28. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në datën 11.07.2019, ora 12.00, në Pallatin e Koncerteve, kati 0, salla B, Tiranë, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra.

VLERËSIMI I PASURISË

29. ILDKPKI-ja ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, duke krahasuar: deklaratën e pasurisë “Vetting”; deklaratat e pasurisë në vite; dhe dokumentacionin justifikues bankar, jo bankar, etj., të dorëzuar nga vetë subjekti me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës me institucionet publike.

29.1 Në përfundim të veprimeve verifikuese ILDKPKI, bazuar në nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë ndër vite;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

30. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, për verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; për verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme, të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016, nga ku rezulton se:

I. Apartament banimi me sip. 121 m², ndodhur në Rr. “**”,** përfituar me kontratën e kalimit të kredisë me nr. ***, në vlerën 54.660 euro, në datën 20.6.2006, mbi bazën e kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 6.7.2004.

I/a Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

31. Subjekti i rivlerësimit ka lidhur një kontratë kalim kredie dhe premtim shitje me nr. ***, datë 20.6.2006, me shtetasin J.Zh. Në këtë kontratë parashikohet se: nga z. J.Zh. sipas kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 6.07.2004, është prenotuar një apartament i ndërtuar nga shoqëria e ndërtimit “****” sh.p.k., me sip. 129 m², me vlerë të përgjithshme në shumën 54.660 euro.

Z. J.Zh. në cilësinë e porositësit ka shlyer shumën 30.000 euro, ndërsa shuma e mbetur prej 24.660 euro, do të paguhej nga subjekti i rivlerësimit i cili merrte përsipër që ti paguante shumën 30.000 euro z. J.Zh. brenda një afati kohor prej 3 vjetësh.

32. Kontrata përfundimtare e shitblerjes me nr. *** është bërë në datën 19.9.2007, në vlerën 46.000 euro, për shkak të sipërfaqes më të vogël dhe për shkak të punimeve të pabëra. Në këtë kontratë përcaktohet se çmimi i shitjes në kontratën e sipërmarrje ka qenë në vlerën 54.660 euro dhe se ai është ulur për shkak se punimet në apartament nuk kapin vlerën e kërkuar nga shitësi.

33. Për të vërtetuar shlyerjen e detyrimeve kundrejt z. J.Zh. subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur dy deklaratat (kopje) të nënshkruara nga z. J.Zh. por që nuk janë bërë përpara noterit publik. Në deklaratën e datës 15.7.2006, z. J.Zh., deklaroi se referuar sipërfaqes më të vogël që rezultoi për apartamentin dhe punimeve ndërtimore të papërfunduara në apartament detyrimi i subjektit të rivlerësimit ndaj tij do të jetë 22.000 euro.

34. Me shkresë të datës 13.7.2017 shoqëria “****” sh.p.k., informon ILDKPKI-në se arsyet e uljes së çmimit të apartamenti janë se pas matjeve të bëra apartamenti kishte sip. 121 m², duke e

korrigjuar këtë sipërfaqe në kontratën përfundimtare nr. ***, datë 19.09.2007, si dhe për shkak të disa punimeve të pabëra të cilat nuk janë specifikuar.

34.1 Nga verifikimi i kontratës së sipërmarrjes dhe kontratës së shitjes rezulton se sipërfaqja e apartamentit nuk ka ndryshuar pasi ajo në të dy kontratat është 129 m², por në kontratën e shitjes është ndarë sipërfaqja e apartamentit nga ambientet e përbashkëta, ndërsa në atë të sipërmarrjes është përcaktuar sipërfaqja në total, duke përfshirë dhe ambientet e përbashkëta.

34.2 Bashkëlidhur kontratës së shitblerjes gjendet dhe vërtetimi hipotekor i datës 20.6.2006 nga ku rezulton se apartamenti është i regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 29.6.2005, me sip. 121 m². Mbështetur në këtë fakt rezulton se shoqëria ndërtimore ka qenë në dijeni të kësaj sipërfaqe kohë më parë se hyrja në marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, Për sa më sipër rezulton se palët kishin dijeni për sipërfaqen 121 m² që në momentin e nënshkrimit të kontratës së kalimit të kredisë dhe premtim shitjes nr. ***, datë 20.6.2006.

34.3 Gjithashtu, edhe në kontratën e kredisë të lidhur nga subjekti i rivlerësimit në pikën 14 të saj sipërfaqja e këtij apartamenti rezulton 121 m², pra, subjekti i rivlerësimit ka qenë në dijeni që në momentin e nënshkrimit të kontratës së kalimit të kredisë dhe premtimit të shitjes nr. ***, datë 20.6.2006, se sipërfaqja e apartamentit ishte 121 m².

34.4 Në lidhje me këto konstatime i është kërkuar informacion shoqërisë “****” sh.p.k. e cila sqaroi se sipërfaqja është përcaktuar në momentin e marrjes në dorëzim të apartamentit. Në kontratën e sipërmarrjes nr. ***, të lidhur me z. J.Zh. sipërfaqja është parashikuar 129 m² për t’u dorëzuar, por në momentin përfundimtar të dorëzimit dhe kolaudimit të objektit rezultoi 121 m² ose 8 m² më pak, dhe kjo sipërfaqe është regjistruar në hipotekë.

34.5 Në deklaratën e datës 28.12.2009, z. J.Zh., deklaroi se në datën 1.8.2006 i janë paguar 15.000 euro nëpërmjet llogarisë bankare në “Emporiki Bank” dhe pjesa tjetër prej 7.000 euro është paguar me këste duke filluar nga muaji gusht 2006 deri në 28.12.2009.

34.6 Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me çmimin e apartamentit në deklaratën periodike të interesave private të vitit 2006, deklaroi blerjen e apartamentit me sipërfaqe 121 m² për vlerën 54.660 euro dhe jo siç deklaroi në deklaratën “Vetting” në shumën 46.000 euro.

34.7 Në këtë deklaratë periodike të interesave private të vitit 2006 subjekti i rivlerësimit nuk jep asnjë shpjegim për uljen e çmimit apo për reduktimin e detyrimit ndaj z. J.Zh.

35. Nga analiza e deklaratës “Vetting” në raport me deklaratimet ndër vite të administruara në dosjen e ILDKPKI-së dhe dokumentacionit siguruar nga Komisioni nëpërmjet hetimit administrativ, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, dhe në paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime dhe prova të tjera për të provuar të kundërtën për:

- mosdeklarim të fitimit të pronësisë së këtij apartamenti në deklaratën periodike të vitit 2007 dhe në deklaratën periodike të vitit 2006;
- deklarime kontradiktore dhe të pashoqëruara me dokumentacion ligjor provues lidhur me uljen e çmimit të blerjes së kësaj pasurie, si dhe mënyrën e shlyerjes së vlerës së këtij apartamenti;
- mungesë dokumentacioni ligjor dhe financiar për shlyerjen e detyrimit të mbetur ndaj z. J.Zh. në vlerën 7.000 euro;
- mosdeklarim në deklaratat periodike vjetore të vitit 2009 dhe 2010 të marrjes së shumës 1.000 euro nga të afërmit dhe kthimin e saj;
- deklarim të pasaktë të përfituesit dhe vlerës 24.000 euro në deklaratën “Vetting”.

I/b Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

36. Pas kalimit të barrës së provës me shpjegimet dhe provat e protokolluara në Komision me nr. *** prot., datë 10.6.2019, subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, shpjegoi sa më poshtë:

36.1 Në deklarin periodik të vitit 2006 në rubrikën “detyrimet financiare ndaj personave juridike dhe fizikë”, ka deklaruar saktësisht sipas kuadrit ligjor në fuqi detyrimet e lindura për këtë vit deklarimi. Konkretisht, ka deklaruar kredi për blerje apartamenti tek “Emporiki Bank” në shumën 40.000 euro, duke pasqyruar në këtë rubrikë edhe të dhënat për apartamentin e ndodhur në Rr. “****”.

36.2 Nuk qëndron konstatimi se në deklarin periodik të vitit 2006 nuk i ka deklaruar saktësisht pasurinë e paluajtshme, të drejtat reale, vlerën dhe pjesën takuese, pasi në rubrikën “ndryshime të interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme” pasqyrohet që ky apartament ka kaluar në pronësinë e subjektit një vit më vonë në 19.9.2007. Pasuria në vetvete është ajo e shënuar në aktet e fitimit të pronësisë dhe nuk ka asnjë fshehje apo pasaktësi të qëllimtë.

36.3 Në deklarin periodik të vitit 2007, ashtu si në vitet e tjera, deklarohet saktësisht si detyrim financiar kredia tek “Emporiki Bank” për blerjen e apartamentit të cituar. Edhe në deklarin “Vetting” të vitit 2017 subjekti ka pasqyruar përshkrimin e kësaj pasurie, burimin e krijimit, çmimin e blerjes, pra, është deklaruar fitimi i pronësisë mbi apartamentin me sipërfaqe 121 m² sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 19.9.2007. Konfuzioni që lidhet me diferencën në vlerë të sipërfaqes të apartamentit është sqaruar bindshëm.

36.4 Në lidhje me këtë fakt, subjekti ka vënë në dijeni edhe porositësin e parë, z. J.Zh., (dhe ky problem është zgjidhur, duke i kthyer shoqëria ndërtuese z. J.Zh. vlerën e diferencës së sipërfaqes dhe vlerën e punimeve të pakryera nga shoqëria në apartament). Faktet e mësipërme janë pasqyruar qartësisht në kontratën përfundimtare të shitjes së apartamentit të datës 19.9.2007.

36.5 Deri në momentin e kalimit të pronësisë me kontratë shitje, marrëdhënia e një kontrate porosie dhe kalim të drejtash, për shkak të ndryshimeve të porosisë në lidhje me sipërfaqen, si dhe me punimet e pakryera nga shoqëria dhe të kryera prej subjektit, u ra dakord që vlera e shitjes së apartamentit të ishte në masën 46.000 euro, e përcaktuar në kontratën e shitjes.

36.6 Është i vërtetë fakti se në deklaratat periodike vjetore, të vitit 2009 dhe 2010, nuk ka deklaruar marrjen hua të shumës 1.000 euro nga të afërmit (baxhanaku, z. F.Xh.) dhe kthimin e saj (duke qenë vlerë e ulët është shlyer menjëherë).

I/c Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

37. Trupi gjykues analizoi shpjegimet e mësipërme dhe provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, dhe bazuar në provat dhe faktet e analizuara së bashku, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës, për sa Komisioni kishte konstatuar në rezultatet e hetimit, sipas referimeve të pikës 35 të këtij vendimi.

38. Trupi gjykues bazuar në pikën 7, të nenit 49, konsideroi të panevojshme këqyrjen e apartamentit ndodhur në Rr. “****”, Tiranë, të kërkuar nga subjekti i rivlerësimit, duke arsyetuar se fakti që kërkohej për t’u provuar nga subjekti, konsiderohet i provuar gjatë gjykimit të çështjes administrative nga trupi gjykues.

II. Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”

II/a Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

39. Si burim për krijimin e këtij apartamenti subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting”, kredi në vlerën 40.000 euro marrë në datën 19.7.2006, në “Emporiki Bank” dhe vlerën 7.000 euro detyrim ndaj personave të tretë. Kredia në bankë është shlyer dhe mbyllur në datën 5.7.2006, nëpërmjet pagesës së vlerës 30.000 euro të përfituar nga shoqëria “****” (*** sh.p.k), për llogari të kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 9.6.2011, të realizuar midis shoqërisë ndërtuese dhe

shtetasve B.M. dhe A.M. (babai dhe vëllai i subjektit të rivlerësimit), në pronën e të cilëve është realizuar ndërtimi i shoqërisë ndërtuese.

39.1 Komisioni analizoi sa subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për shlyerjen e kredisë në bankë mbyllur në datën 5.7.2006 dhe gjithë transaksionet e kryera nga familjarët nga fitimi e pronësisë për pronën e deri te shkëmbimi i kryer me shoqërinë “***” sh.p.k.

40. Babai i subjektit ka blerë një toke arë me sip.1.000 m², në vlerën 2.000.000 lekë, në Yzberisht, Tiranë, nga shitësit B.E. dhe F.E., me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 14.11.1998, përpara noteres N.K.

41. Në kontratën nr. ***, datë 12.9.2000, të shitjes së tokës nga babai i subjektit, z. B.M., ka rezultuar, si më poshtë vijon:

42. Subjekti, ka bashkëlidhur deklaratës “Vetting”, kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 12 shtator 2000, përpara noteres H.G., sipas së cilës babai i subjektit, z. B.M., i shet vëllait të subjektit, z. A.M., tokën arë me sip. 332 m² me nr. pasurie ***, kundrejt vlerës 100.000 (njëqind mijë) lekë.

42.1 Gjatë hetimit administrativ dhe përgjigjeve të pyetësorit subjekti i ka dërguar Komisionit kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 12 shtator 2000, përpara noteres H.G. sipas të cilës z. B.M. i shet z. H.M., znj. Dh.L. dhe z. A.M., tokë arë me sip. 1000 m² me nr. pasurie *** kundrejt shumës 200.000 lekë.

42.2 Komisioni, gjatë të hetimit administrativ në datën 31.1.2018, në kushtet kur ka administruar dy kontrata të hartuara para të njëjtës notere me të njëjtin numër repertori dhe koleksioni, dhe me përmbajtje të ndryshme, lidhur me palët, me objektin, dhe me vlerën për të saktësuar situatën, e për të arritur në një rezultat hetimi sa më të drejtë dhe të gjithanshëm, si dhe për të vendosur se cila nga kontratat ishte varianti i saktë që do të merrej në konsideratë, ndërmori hapat hetimore si më poshtë:

43. Thirri në cilësinë e dëshmitares znj. H.G. nëpërmjet njoftimit zyrtar, për të dhënë shpjegime për ekzistencën e dy kontratave me përmbajtje të ndryshme me të njëjtin numër repertori dhe koleksioni, me përmbajtje të ndryshme lidhur me palët, me objektin, dhe me vlerën, të hartuara në zyrën e saj noteriale.

44. I kërkoi subjektit dhënien e shpjegimeve nëpërmjet pyetjes 8 të dërguar me *e-mail-in* e datës 19.2.2019, si vijon: nga dokumentacioni i paraqitur nga ju rezultojnë dy kontrata shitblerje që kanë të njëjtin nr. *** rep., dhe me të njëjtin nr. *** kol., datë 12 shtator 2000, të lidhura përpara noteres H.G., nga verifikimi i këtyre kontratave vihet re se janë me përmbajtje të ndryshme lidhur me palët, me objektin, dhe me vlerën, e duke ia vendosur bashkëlidhur e-mail-it këto kontrata.

45. Në datën 31.1.2018 pasi u thirr në cilësinë e dëshmitares znj. H.G. deklaroi se e regjistruar në regjistrin noterial të saj është kontrata sipas të cilës z. B.M. ia shet tokën arë me sip. 361 m², z. H.M., tokën arë me sip. 307 m², znj. Dh.L. dhe z. A.M. tokën arë me sip. 332 m², në vlerën 200.000 lekë.

46. Në cilësinë e dëshmitares, znj. H.G., deklaroi: *“Kontratat janë redaktuar nga vetë personi Ilir Mustafaj, dhe personat që e shoqërojnë. Ata kishin bërë gabim gjatë redaktimit dhe unë faktikisht kam sjell sot me vete kopjen origjinale. Erdhën me 12 shtator 2000, unë në atë kohë nuk kam patur kompjuter, në atë kohë redaktoja me makinë shkrimi, kjo kontrate u redaktua në një zyre të gjykatës. Nuk i kam pasur klient ka ardhur Iliri bashkë me babain e vet dhe personat e tjerë”*.

47. Në lidhje me deklarinimin nga noterja në dëshminë e saj sipas referimit në pikën 47 të këtij vendimi subjekti solli shpjegime dhe prova, si dhe depozitoi shkresën nr. *** prot., datë 10.6.2019, të cilat çuan trupin gjykues në konkluzionin se deklarinimet në cilësinë e dëshmitares

së znj. H.G. në pikës 46, nuk mund të merren në konsideratë në këtë vendimmarrje. Trupi gjykues ka përjashtuar përdorimin e përmbajtjes së kësaj dëshmie si një garanci më shumë ndaj subjektit të rivlerësimit, pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky i fundit, ka rezultuar egzistenca e një konflikti interesash - që ka ndikuar mbi deklaratimet e znj. G., e ky fakt objektivist vë në dyshim besueshmërinë e saj.

48. Trupi gjykues sipas konfirmimit të subjektit dhe të noteres vlerësoi se kontrata e lidhur mes palëve është ajo sipas të cilës: z. B.M. ia shet tokën arë me sip. 361 m², z. H.M.; tokën arë me sip. 307 m², znj. Dh.L. dhe z. A.M.; tokën arë me sip. 332 m², në vlerën 200.000 leke.

49. Z. B.M., babai i subjektit të rivlerësimit, sipas formularit të vetëdeklarimit, datë 29.8.2006, ka ndërtuar një shtëpie 2-katëshe në vitin 1999 (një kat i ndërtuar; një kat karabina), me sipërfaqe ndërtimi 125 m² dhe sipërfaqe trualli 332 m², për të cilat subjekti deklaroi se ka kontribuar gjithë familja e tij.

50. Komisioni, kreu analizën financiare për llogaritjen e mundësisë financiare të subjektit dhe të familjes së tij për blerjen e tokës dhe ndërtimin e banesës në periudhën 1996 – 2001. Bazuar në këtë analizë i kaloi subjektit të rivlerësimit barra e provës për të provuar të kundërtën në lidhje me pamjaftueshmërinë financiare në vlerën **-1.792.279 lekë** në periudhën 1996 – 2001 për blerjen e tokës dhe ndërtimin e ndërtesës, pamjaftueshmëri kjo pa marrë në konsideratë dhe pa zbritur nga këto të ardhura shpenzimet jetike të familjes së tij.

Nr.	Analiza financiare	1996 - 2001
A	Të ardhurat	3.207.721
1	Paga neto e subjektit në periudhën 1996 – 2001	1.406.445
2	Paga neto e bashkëshortes në vitin 2001	60.000
3	Nga shitja e banesës në Taç, Ersekë, Kolonjë	150.000
4	Vendimi gjyqësor nr. ***, datë 27.6.1997, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë	1.362.000
5	Paga e vëllait në shoq. “***”, nëntor – dhjetor 2001	29 276
6	Shitja e tokës në vitin 2000	200.000
B	Pasuritë	5.000. 000
1	Blerë tokë me sip. 1000 m ²	2.000.000
2	Ndërtimi i katit të I-rë të banesës në periudhën 1999 – 2001	3.000.000
	Rezultati financiar	-1.792.279

II/b Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

51. Pas kalimit të barrës së provës me shpjegimet dhe provat e protokolluara në Komision me nr. *** prot., datë 10.6.2019, subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, paraqiti sa më poshtë:

51.1 Në kontratën e shitjes me nr. ***, datë 14.11.1998, babai ka blerë një tokë me sip. 1.000 m², në vlerën 2.000.000 lekë, por kontribuues në pagimin e vlerës për blerjen e tokës së sipërpërmendur kanë qenë faktikisht edhe xhaxhai i subjektit, z. H.M., si dhe bashkëshortja e kushëririt të parë të nënës Dh.L., të cilët nuk kanë qenë të pranishëm në momentin e fitimit të pronësisë.

51.2 Nëpërmjet një akti ligjor të mëvonshëm, konkretisht, kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 12.9.2000, babai i subjektit u ka kaluar atyre pjesën takuese, përkatësisht sip. 361 m² z. H.M. dhe sip. 307 m² znj. Dh.L., duke mbetur vetëm sipërfaqja prej 332 m² në pronësi të vëllait të subjektit, z. A.M., kaluar këtij të fundit nga babai, sipas kontratës së mësipërme.

52. Subjekti depozitoi provat si vijon:

Prova I “Deklarata e S.L., bashkëshorti i Dh.L., palë në kontratën e shitjes së datës 12.9.2000, deklaratë së cilës i bashkëngjit edhe burimin e të ardhurave të tij nga shitja e shtëpisë në vlerën 600.000 lekë, në fshatin Çarçovë, Përmet. Sipas deklaratës së tij dhe të bashkëshortes, e

administruar me përpara prej Jush në përgjigj të datës 31.12.2018, merret përsipër prej tyre detyrimi prej 614.000 lekësh për sip. 307 m², blerë nga z. B.M. në datën 14.11.1998.

Prova 2. Deklarata e z. E.M. (djali i xhaxhait të subjektit), emigrant dhe shtetas gjerman prej vitit 1993 e në vijim, djali i H.M., palë në kontratën e shitjes së datës 12.9.2000, deklaratë së cilës, i bashkëngjit dhe burimin e të ardhurave nga puna e tij dhe e bashkëshortes së tij në Gjermani për periudhën 1994 — 2000: certifikata e martesës në Gjermani; libreza e kursimit në Gjermani (ku në vitin 1998, vit i blerjes së tokës, ka bërë tërheqje kursimesh nga libreza e tij), dokumentacioni i mësipërm i përkthyer dhe i noterizuar. Sipas deklaratës së tij dhe deklaratës së babait të tij, e administruar me përpara prej Jush në përgjigje të datës 31.12.2018, merret përsipër detyrimi i shumës prej 722.000 lekësh për sip. 361 m², blerë në datën 14.11.1998, nga B.M.

53. Bazuar në këto prova ai kërkoi që çmimi parashikuar për blerjen e tokës nga babai z. B.M., në datën 14.11.1998, të jetë 664.000 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 1.336.000 (një milion e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë)lekë te llogaritet se është paguar: shuma 772. 000 lekë nga z. H.M. e shuma 614.000 lekë nga znj. Dh. dhe z. S.L.”.

Ai gjithashtu për shitjen e tokës nga babai, z. B.M. deklaroi se “vlera e vënë në kontratën nr. ***, datë 12.9.2000, prej 200.000 lekësh, sipas edhe thënieve të familjareve të mi, vlerësoj se ka qenë deklarative, thjeshtë si element i kontratës së shitjes”.

54. Subjekti i kërkoi Komisionit edhe marrjen në konsideratë të sa ekspertit kontabël i regjistruar, z. B.P., ka llogaritur mbi gjendjen financiare të subjektit dhe të familjes së tij për periudhën 1996 – 2001, sipas të cilit vlera e blerjes së tokës është me sip. 332 m² dhe vlera e ndërtimit të katit të parë të banesës dhe e mobilimit të saj, janë në masën 3.664.000 lekë (664.000 lekë vlere e tokës + 3.000.000 lekë vlere e ndërtesës + mobilimi).

II/c Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

55. Trupi gjykues analizoi shpjegimet dhe provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, dhe bazuar në provat dhe faktet e analizuara së bashku, arsyeton se

55.1 Përlllogaritja e ekspertit kontabël, z. B.P., për çmimin e blerjes së tokës nga babai i subjektit (664.000 lekë), dhe për çmimin e shitjes së tokës nga babai i subjektit nuk bazohen në kontratat e lidhura mes palëve.

56. Shpjegimet e dhëna nga subjekti se:

56.1 “De facto sipas kontratës së shitjes me nr. ***, datë 14.11.1998, kanë qenë pronarë në sip. 1.000 m², B.M. për sip. 332 m² (664.000 lekë), H.M. për sip. 361 m² (722.000 lekë) dhe Dh.L. për sip. 307 m² (614.000 lekë)”

56.2 “Vlera e vënë në kontratën nr. ***, datë 12.9.2000, prej 200.000 lekësh, sipas edhe thënieve të familjareve të mi, vlerësoj se ka qenë deklarative, thjeshtë si element i kontratës së shitjes”.

vijnë në kundërshtim, me sa vijon:

- parashikimet e nenit 690 të Kodit Civil, i cili përcakton: “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të ndryshohet me pëlqimin e palëve ose për shkaqet e parashikuara me ligj”. Kontrata e përpiluar nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre”;

- parashikimet e nenit 659 të Kodit Civil ku parashikohet: “Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike”;

- parashikimet e nenit 660 të Kodit Civil ku parashikohet: *“Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi”*;

- parashikimet e nenit 663 të Kodit Civil në të cilin përcaktohen kushtet e nevojshme për lidhjen dhe vlefshmërinë e kontratës, të cilat janë: *“Pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin; shkak i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi; objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji”*.

57. Deklaratat noteriale të z. H.M. dhe znj. Dh.L. janë bërë gjatë hetimit administrativ dhe për këtë arsye ato ka vlerë të kufizuar ligjore, pasi palët kanë pasur të gjitha mundësitë ligjore të parashikonin sa deklarohet në këto deklarata në hartimin e dokumenteve ligjore të kryerjes së veprimeve juridike mes tyre.

58. Trupi gjykues vlerëson se nuk ekziston asnjë shkak ligjor që të vërë në dyshim vërtetësinë e fakteve të përshkruara në kontratat noteriale të lidhura mes palëve, përfshirë këtu çmimin e parashikuar për blerjen e tokës nga babai i subjektit, z. B.M., në kontratën noteriale nr. ***, datë 14.11.1998, dhe çmimin e parashikuar në kontratën nr. ***, datë 12.9.2000, për shitjen e tokës nga babai i subjektit, z. B.M.

58.1 Në analizën financiare të subjektit dhe familjes së tij, referuar kontratave noteriale të lidhura mes palëve trupi gjykues vendosi si shpenzim vlere 2.000.000 lekë për blerjen e tokës në datën 14.11.1998, dhe si e ardhur vlera 200.000 lekë për shitjen e tokës në datën 12.9.2000.

59. Komisioni, në analizën financiare ka marrë në konsideratë të ardhura të subjektit dhe të familjes për të cilat subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues, si më poshtë:

- paga neto e subjektit për periudhën 1996 – 2001, në vlerën totale 1.406.445 lekë, provuar me vërtetimin nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- paga neto e bashkëshortes në vitin 2001 në vlerën 60.000 lekë, provuar me vërtetim;
- të ardhura në vlerën 150.000 lekë nga shitja e banesës në fshatin Taç, Ersekë, Kolonjë, sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., datë 17.12.1996;
- të ardhura nga vendimi gjyqësor nr. ***, datë 27.6.1997, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, 1.184.000 lekë,
- interesi bankar në vlerën 178.000 lekë, për depozitimin 6-mujor në vitin 1997 në vlerën 1.362.000 lekë, sipas shkresës nr. ***, datë 22.02.2019, të “Raiffeisen Bank”;
- të ardhura të vëllait të subjektit, z. A.M. , në kompaninë “****” me detyrën menaxher për periudhën nëntor – dhjetor 2001, në shumën 29.276 lekë.

60. Komisioni, në analizën financiare nuk ka marrë në konsideratë të ardhura të subjektit dhe të familjes për të cilat subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor provues, si më poshtë:

- të ardhurat e tërhequra nga babai gjatë viteve 1997 – 1998 në transaksionin *cash* në shumën 420.871 lekë të investimit në letra me vlerë në shoqatën e të përndjekurve politikë “***”, Vlorë.
- të ardhurat nga shitja e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale dhe gjësë së gjallë, deklaruar në vlerën 350.000 lekë;
- të ardhurat nga prindërit e subjektit për periudhën 1997 – 2001, si shitës ambulante në tregun e fruta-perimeve pranë Drejtorisë së Policisë Tiranë, rreth 25.000 lekë/muaj,
- të ardhurat e realizuara nga vëllai i subjektit, z. A.M., nga puna e tij si emigrant në Greqi, për periudhën 1991 – 2000, në shumën 150.000 drahmi në muaj dhe kursimet në shumën rreth 70.000 drahmi në çdo muaj.
- të ardhura interesi bankar në shumën **263.893 lekë**, për periudhën janar 1998 - tetor 1998.

61. Trupi gjykues bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, pas analizimit edhe të shpjegimeve dhe provave të subjektit, z. Ilir Mustafaj, dhe akt-ekspertimit kontabël të audituesit

ligjor z. B.P., arrin në përfundimin se subjekti rivlerësimi dhe familjarët e tij kanë pasur pamjaftueshmërinë financiare në vlerën **-1.792.279 lekë** për blerjen e tokës dhe ndërtimin e katit të parë të ndërtesës, pasuri këto që shërbyen si burim krijimi për pasurinë e deklaruar në “Vetting”.

III. Mbi shumën e përfituar nga shoqëria “**” sh.p.k**

III/a Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

62. B. dhe A.M., babi dhe vëllai i subjektit të rivlerësimit, në këmbim të sipërfaqes së tokës prej 332 m², të blerë në datën 14.11.1998, dhe të banesës të ngritur mbi këtë pronë, të ndodhur në Yzberisht, Tiranë, kanë përfituar nga shoqëria ndërtuese, me kontratën e sipërmarrjes nr. *** të datës 9.6.2011, midis “****” sh.p.k., njësi parkimi, njësi tregtare dhe sipërfaqe banimi.

63. Në të njëjtën datë me kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 9.6.2011, është lidhur aneksi i kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 9.6.2011, nënshkruar vetëm nga vëllai dhe babai i subjektit të rivlerësimit, përkatësisht, z. A.M. dhe z. B.M.

64. Sipas aneksit të kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 9.6.2011, porositesit z. A.M. dhe z. B.M., deklarojnë që nga kjo kontratë do të përfitojë edhe vëllai tjetër, z. Ilir Mustafaj, vlerën prej 30.000 euro që është konvertim i sipërfaqes 50 m², vlerë e cila do të përdoret prej tij për shlyerjen e kredisë së marrë në “Emporiki Bank”.

65. Sipas këtij aneksi, z. Ilir Mustafaj, do të paraqitej në shoqëri për tërheqjen në *cash* të shumës prej 30.000 euro.

66. Referuar deklaratës “Vetting” kjo shumë e përfituar nuk është përmendur në rubrikën e të ardhurave të përfituara nga subjekti i rivlerësimit sipas detyrimit të Udhëzimit të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj.” i cili në pikat 7, 15, 18 dhe 22 përcakton: “7. *Për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj*”.

67. Në deklaratën e pasurisë për vitin 2011, subjekti ka deklaruar se përveç shumës 30.000 euro, do të përfitonte edhe sipërfaqe ndërtimore nga sipërfaqja takuese që do t’u takojë porositesve në momentin kur të bëhet kalimi i pronësisë së pjesës që u takon pronarëve të truallit. Kjo shprehje është marrë fjalë për fjalë siç kanë shprehur vullnetin babai dhe vëllai në aneksin e kontratës së sipërmarrjes me nr. ***, datë 9.6.2011, hartuar para noteres Xh.B., vullneti i cili është shprehur në të njëjtën mënyrë edhe për vëllain e subjektit, z. D.M.

68. Gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, në përgjigjet e datës 31.12.2018, subjekti deklaroi: “*Kjo vlerë është përfituar, nisur nga fakti se unë kam qenë në jetesë të përbashkët me familjen time dhe kontribuues në momentin e blerjes së truallit dhe ndërtimit të banesës mbi këtë truall, si dhe cilësinë e trashëgimitarit të nënës sime, e cila ka ndërruar jetë në datën 21.3.2011*”.

69. I pyetur nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit, mbi dokumentacionin ligjor provues të pagesës së detyrimeve tatimore për shumën e përfituar nga ai prej 30.000 euro ka deklaruar: “*Nuk është detyrimi i familjarëve pagesa e tatimit dhe nuk ka si të ketë një dokument për pagesën e tatimit. Ky tatim, duhet të jetë deklaruar dhe paguar nga ndërtuesi. Ligji ia ngarkon detyrimin investitorit për deklarimin dhe pagesën e tatimit që i takon edhe pjesës që i takon sipërfaqes së shkëmbyer.*”

70. Nga analiza e deklaratës “Vetting” në raport me deklaratimet ndër vite të administruara në dosjen e ILDKPKI-së dhe dokumentacionit siguruar nga Komisioni nëpërmjet hetimit administrativ, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, dhe në paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime dhe prova të tjera për të provuar të kundërtën për:

- Duket se aneksi i kontratës së sipërmarrjes si akt që sjell ndryshime ose plotësime në kontratën e sipërmarrjes (iu jepte të drejta si një palë e tretë të paraqiteshit personalisht pranë shoqërisë për tërheqjen e vlerës prej 30.000 euro), nuk ka formën e kërkuar ligjore, pasi nuk është reregjistruar si veprim më vete me numër repertori dhe koleksioni në regjistrin noterial të noterit.
- Duket se ka deklarime kontradiktore ndërmjet subjektit dhe përfaqësueses të shoqërisë për sa i përket datave të akteve ligjore mbi të cilat është bërë pagesa e shumës 30.000 euro.
- Duket se nuk ka paguar tatimin për shumën 30.000 euro të cilën e keni deklaruar si burim për shlyerjen e kredisë që morët për blerjen e apartamentit të banimit me sipërfaqe 121 m².
- Shoqëria “***” sh.p.k. ka bërë deklarinimin e kësaj shumë në DPPPP-në, pikërisht në datën 28.1.2017 që është data e dorëzimit të deklaratës “Vetting” nga ju në ILDKPKI, duke krijuar dyshime se deklarimi është kërkuar nga subjekti =në kohën e plotësimit të deklaratës “Vetting”.
- Gjatë plotësimit të deklaratës “Vetting”, si dhe gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, nuk keni paraqitur asnjë akt noterial ose vendim gjykate që konfirmon sa ju pretendoni se keni përfituar nga dëshmia e trashëgimisë së nënës suaj.

III/b Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Pas kalimit të barrës së provës me shpjegimet dhe provat e protokolluara në Komision me nr. *** prot., datë 10.6.2019, subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, shpjegoi sa më poshtë:

71. Aneksi i kontratës së sipërmarrjes datë 9.6.2011, nuk është regjistruar si veprim noterial më vete në regjistrin noterial, pasi del qartë se ky aneks është pjesë integrale e kontratës së sipërmarrjes me të njëjtin numër repertori dhe koleksioni. Aneks kontrata është veprim juridik, që jo vetëm ka formën e caktuar nga ligji për veprimet e tilla, por që edhe pranohet nga palët pa rezervë. Të njëjtin qëndrim ka edhe noterja, hartuese e kësaj kontrate.

71.1 Në lidhje me faktin se shuma 30.000 euro nuk konsiderohet e ardhur e ligjshme për shkak të mospagimit të tatimit, në zbatim të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, ”Për tatimin mbi të ardhurat”, si dhe udhëzimin e përbashkët nr. 9, datë 26.02.2008 të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë, të cilat janë akte ligjore në fuqi në kohën e lidhjes së kontratës, tatimi nuk iu përket familjarëve (pronarëve të tokës dhe ndërtesës), por tatimi i takon shoqërisë ndërtuese “***” sh.p.k.

71.2 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr. ***, datë 31.5.2019, konfirmon: *“Referuar përcaktimeve në legjislacionin që ka qenë në fuqi, në kohën e lidhjes së kontratës, të ardhurat e përfituara nga kontrata e shkëmbimit të truallit me sipërfaqe ndërtimi, nuk përbëjnë të ardhura të tatueshme për pronarët e truallit.”* Kjo provohet edhe nga kontrata përfundimtare e shkëmbimit me nr. ***, datë 5.5.2018, e lidhur ndërmjet investitorit, shoqërisë ndërtuese dhe pronarëve A.M. dhe B.M., si përfitues të vetëm të sipërfaqeve ndërtimore.

71.3 Ligji që ka qenë në fuqi, gjatë kohës kur është kryer transaksioni në vlerën 30.000 euro, përcakton: *“Për veprimtaritë e ndërtimit dhe shitjes me destinacion për strehim, veprimtari prodhuese, veprimtari tregtare ose shërbimi, në të ardhurat e tatueshme të investitorit llogariten edhe të ardhurat që i korrespondojnë pjesës së sipërfaqes së ndërtimit që përfitojnë pronarët e truallit për rastet e kontratave të këmbimit truall sipërfaqe ndërtimi.”*

71.4 Ndërtuesi me të cilin është lidhur kontrata e shkëmbimit, si investitor ka pasur detyrimin që të deklarojë dhe të paguajë tatimin mbi të ardhurat që i korrespondojnë pjesës së sipërfaqes së truallit të shkëmbyer. Në këtë kuptim nuk është detyrimi i familjarëve pagesa e tatimit dhe nuk ka si të ketë një dokument për pagesën e tatimit. Ky tatim duhet të jetë deklaruar dhe të jetë paguar nga ndërtuesi.

72. Me shkresën nr. ***, datë 10.6.2019, dërgim dokumentacioni pika 56, subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, paraqiti Komisionit kërkesë për thirrje në cilësinë e dëshmitarit, administratorin e shoqërisë "****" sh.p.k., pasi prej tij si përfaqësues ligjor i shoqërisë janë kryer të gjitha veprimet juridike referuar ne raport.

73. Trupi gjykues bazuar në pikën 7, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, e konsideroi të panevojshme thirrje në cilësinë e dëshmitarit të administratorit të shoqërisë "****" sh.p.k., për sa më poshtë vijon:

73.1 Nga Komisioni është thirrur me shkresën nr. *** prot., datë 25.1.2019, përfaqësuesi i shoqërisë "****" sh.p.k. (***), për të dhënë shpjegime.

73.2 Përfaqësuesi i shoqërisë "****" sh.p.k. pasi ka konfirmuar dhënien e dëshmisë ditën e martë 5.2.2019, në orën 12:00, ka dërguar në Komisionin në cilësinë e përfaqësuesit juristen e cila konfirmoi se kishte vetëm 9 muaj punë pranë kompanisë. Për këtë arsye u gjykua e pamundur nga trupi gjykues të pyetej përfaqësuesja e dërguar.

73.3 Trupi gjykues i ri-kërkoj shoqërisë "****" sh.p.k., me *e-mail-in* e datës 19.6.2019, për dhënien e dëshmisë të paraqitë një punonjës apo përfaqësues i shoqërisë i cili të kishte dijeni për faktet dhe të dhënat e kërkuara, duke shpjeguar se informacionet që duhet të merren janë të një natyre jo vetëm juridike, por kërkojnë edhe njohuri të shtuara nga përfaqësuesi që do të dërgohej në Komision në lidhje me faktet dhe rrethanat që kanë ndodhur në vitin 2011, si dhe me ndërtimin e bërë në këtë vit, përveç të tjerash edhe në pronën e familjes Mustafaj.

73.4 Në përgjigje të këtij *e-mail-i* shoqëria ka dërguar si përfaqësuese të kompanisë punonjësën e financës znj. N.K., e punësuar në kompani në vitin 2011, me autorizimin nr. ***, datë 5.1.2019, ajo ishte autorizuar nga administratori i shoqërisë E.N., të përfaqësonte shoqërinë për dhënien e dëshmisë në kuadrin e analizës së marrëdhënies juridike mes shoqërisë dhe z. B. e A.M.

73.6 Komisioni, bazuar në sa më sipër e konsideroi të panevojshme thirrjen e përfaqësuesit të shoqërisë "****" sh.p.k., si dëshmitar për sa kohë dëshmia është dhënë nga përfaqësuesja e autorizuar prej tij dhe në dijeni të rrethanave të vitit 2011.

73.7 Gjatë dëshmisë së dhënë në datën 5.2.2019 përfaqësuesja e shoqërisë kur u pyet për pagesën e tatimeve deklaroi ndër të tjera: *"Nuk janë bërë fatura tatimore, si dhe nuk janë reflektuar tek pasqyrat financiare të vitit 2011, pasi këto janë shpenzime dhe në rast se do i kishin pasqyruar do kishin paguar më pak tatim"*.

III/c Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me ligjin e zbatueshëm

73.8 Trupi gjykues analizoi shpjegimet dhe provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, dhe bazuar në provat dhe faktet e analizuara së bashku, arsyeton se nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit së bashku me argumentimet e tij, si dhe nga analiza e shkresës me nr. ***, datë 31.5.2019, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ka rezultuar se shuma prej 30.000 euro e përfituar dhe e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2011, ka qenë legjitime dhe me burim të ligjshëm.

73.9 Përfitimi i shumës në fjalë ka qenë rezultat i një veprimi juridiko-civil në kornizën e lirisë kontraktore të individëve. Nga analiza e dokumentacionit përkatës rezulton se palët janë dakordësuar me vullnetin e tyre të lirë, dhe pa pretendime të mëpasshme, për më tepër që në rastin konkret subjekti i rivlerësimit, për nevoja të menjëhershme, ka marrë paraprakisht një pjesë të të drejtave të tij pasurore që i përkisnin si trashëgimi nga nëna e vet, në mirëkuptim me familjarët e tjerë. Komisioni çmon se nuk ka dyshime mbi transaksionin e shumës së marrë nga subjekti në vitin 2011, dhe as mbi legjitimitetin e këtij të fundit për të përfituar dhe disponuar shumën prej 30.000 euro.

73.10 Shuma prej 30.000 euro e përfituar nga subjekti ka rezultuar me burim të ligjshëm – dhe në përputhje me parashikimet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës – nga momenti që nga analiza e dispozitave ligjore në fuqi në vitin 2011 (konkretisht ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", si dhe udhëzimi nr. 9, datë 26.2.2008, i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë), ka rezultuar se detyrimi tatimor mbi shumën në fjalë nuk u përkiste familjarëve të subjektit, por shoqërisë ndërtuese. Në fakt, ka qenë shoqëria ndërtuese, "***", me të cilën ishte lidhur kontrata e shkëmbimit të truallit, që në cilësinë e investitorit ka mbartur detyrimin që të deklarojë dhe të paguaj tatimin mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e sipërfaqeve të ndërtuara, dhe rrjedhimisht edhe për sa i përket pjesës së sipërfaqes së ndërtimit të shkëmbyer me truallin, në bazë të kontratës së datës 9.6.2011. Përveç të tjerash, i njëjti konkluzion është arritur/komunikuar edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, i cituar më lart. Për rrjedhojë, shuma prej 30.000 euro duhet konsideruar si një burim i ligjshëm financiar në dispozicion të subjektit të rivlerësimit në vitin 2011.

73.11 Komisioni, gjithashtu, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar shumën prej 30.000 euro, në rubrikën e të ardhurave të përfituara, në deklaratën "Vetting", dhe kjo e bën të pamjaftueshme këtë deklaratë, me pasojat e rastit, por ky mosdeklarim nuk mund ta bëjë jo ekzistuese këtë shumë – realisht të poseduar dhe të përdorur nga subjekti.

IV. ANALIZA FINANCIARE

74. Gjatë hetimit administrativ është kryer një analizë e hollësishme financiare e pasurive të subjektit të rivlerësimit bazuar në gjendjet e likuiditeteve, në të ardhurat e ligjshme, shpenzimet, detyrimet financiare të deklaruara nga subjekti, duke i krahasuar ato me informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore.

75. Subjektit të rivlerësimit, në bazë të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, iu kalua barra e provës, për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera dhe për të provuar të kundërtën lidhur me likuiditete të pajustificuara në vitet 2009, 2011, 2013.

75.1 Për gjendjen *cash* të deklaruar për t'i konsideruar nga Komisioni si të ardhura të disponueshme në vitin pasardhës subjekti gjatë seancës dëgjimore kërkoi të njëjtin standard që kishin rastet e tjera analoge të nxjerra nga vendimet e dhëna nga ky trup gjykues.

75.2 Trupi gjykues nuk konstaton në vendime të tjera fakte apo rrethana të njëjta me ato që janë shqyrtuar në këtë vendim – ku qëndrimi i trupit gjykues është argumentuar në specifikën e tij. Gjithashtu, vlerësohet se qëndrimet e mbajtura në vendimet e tjera nga Komisioni, për subjekte të tjera të rivlerësimit, nuk janë detyruese dhe nuk kushtëzojnë vlerësimet e trupit gjykues në çështjet që gjykon, siç pretendon subjekti.

IV/a Në lidhje me pamjaftueshmërinë financiare në vitin 2009

76. Rezultoi se në llogarinë e pagës nr. *** në vitin 2009 në "Raiffeisen Bank" subjekti nuk e ka tërhequr pagën, gjatë gjithë vitit duke e shtuar gjendjen në fund të vitit në shumën 934.947 lekë.

77. Nga analiza e deklaratës "Vetting" në raport me deklaratimet ndër vite të administruara në dosjen e ILDKPKI-së dhe dokumentacionit siguruar nga Komisioni nëpërmjet hetimit administrativ, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, dhe në paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime dhe prova të tjera për të provuar të kundërtën për pamjaftueshmërinë financiare në vitin 2009 për të shlyer këstet e kredive bankare, për të përballuar shpenzimet jetike dhe shpenzime të tjera dhe për të kursyer likuiditetet e krijuara gjendje në llogaritë bankare, duke rezultuar me një bilanc negativ – 1.105.131 lekë.

78. Subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime dhe prova të tjera për të provuar të kundërtën për sa në deklaratën periodike të vitit 2009, subjekti nuk ka deklaruar shtesë në llogarinë bankare në “Raiffeisen Bank” në shumën 934.947 lekë dhe shtesë në llogarinë bankare të bashkëshortes në shumën 366.532 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

79. Pas kalimit të barrës së provës me shpjegimet dhe provat e protokolluara në Komision me nr. *** prot., datë 10.6.2019, subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, shpjegoi sa më poshtë:

79.1 *“Të ardhurat e siguruar nga mësimdhënia për periudhën 2006 – 2009 në Universitetin K., janë në shumën 664.200 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e dyqind) lekë, ku kjo shumë është tërhequr cash gjatë vitit 2009 në zyrën e financës së Universitetit K., me mandatin përkatës së pagesës që për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar nuk e disponoj sot. E ardhura e mësipërme më ka krijuar të ardhura të qëndrueshme gjatë vitit 2009 dhe më ka mundësuar kursimin e të ardhurave nga paga ime dhe e bashkëshortes.*

79.2 *Për të vërtetuar faktin e mësipërm, me anë të shkresës në datën 22.5.2019 i jam drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, duke i kërkuar informacion nëse në dokumentacionin financiar tatimor që disponon ky institucion për Universitetin K. për periudhën 2006 – 2011, disponon të dhëna në lidhje me deklaratimet nga ky subjekt për pagesat e kryera për pedagogët e jashtëm të Fakultetit të Drejtësisë.*

79.3 *Me shkresën nr. *** prot., datë 31.5.2019, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë është shprehur se në përgjigje të kërkesës sime rezulton se nga të dhënat e nxjerra nga arshiva në dosjen e shoqërisë ‘K.’, nuk ka të dhëna në mënyre analitike për pagesat e kryera për pedagogët e jashtëm. Në bilancet e shoqërisë të dhënat e regjistruara janë në total dhe jo analitike.*

79.4 *Në lidhje me faktin e të qenit pedagog i jashtëm në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin K. i jam drejtuar në datën 22.5.2019 me ane të një shkresë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, duke i kërkuar të më konfirmojë listën e pedagogëve të jashtëm të Fakultetit të Drejtësisë se këtij universiteti për periudhën 2007 – 2014, dhe në përgjigje të këtij institucioni me shkresën nr. *** prot., datë 31.5.2019, ministria më ka informuar se nuk disponon asnjë informacion në lidhje me dokumentacionin e personelit akademik që rregullojnë marrëdhëniet e punës me ish-Shkollën e Lartë universitare jopublike Universiteti K., theksohet se i vetmi dokumentacion i depozituar në ministri është regjistri e matrikullimit të studentëve”.*

79.5 *Në kushtet e mësipërme pika 3, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, parashikon se: “Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj”.*

79.6 *Neni 32, i ligjit nr. 84/2016 parashikon se: “Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme”.*

79.7 *Pas kalimit të barrës së provës subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, bashkëlidhi edhe akt-ekspertimi të datës 7 qershor 2019, nga ekspert kontabël i regjistruar, z. B.P., në të cilin është bërë raport financiar në lidhje me gjendjen financiare të subjektit për vitet 2006 – 2009.*

Arsyetime ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

80. *Trupi gjykues analizoi provat e hetimit administrativ, shpjegimet dhe provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, dhe akt-ekspertimin e datës 7 qershor 2019, nga ekspert kontabël i regjistruar, z. B.P., në të cilin është bërë raport financiar në lidhje me gjendjen*

financiare të tij për periudhën 2006 – 2009, dhe bazuar në provat dhe faktet e analizuara së bashku, arsyeton se:

80.1 Nga eksperti kontabël për të ardhurat nga Universiteti “K.” në periudhën 2006 – 2009, për z. Ilir Mustafaj, për periudhën 2006 – 2009, janë llogaritur në vlerën 664.200 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e dyqind) lekë, shumë kjo e tërhequr nga subjekti në vitin 2009 me para në dore (*cash*).

80.2 Nuk ka asnjë dokumentacion ligjor apo financiar që të vërtetojë se subjekti i rivlerësimit ka tërhequr nga Universiteti “K.” në vitin 2009 shumën prej 664.200 lekësh.

80.3 Shuma prej 664.200 lekësh nuk është deklaruar nga subjekti si e ardhur as në deklaratën “Vetting”, sipas detyrimit të Udhëzimit të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj.” i cili në pikat 7, 15, 18 dhe 22 përcakton: “7. Për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj.”

81. Trupi gjykues u dha deklaratave periodike vjetore të subjektit vlerën e provës në referim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, dhe sipas nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile, dhe duke i çmuar ato me rëndësi provuese për pasurinë objekt kontrolli, së bashku me provat e tjera, vëren se subjekti i rivlerësimit, në deklaratimet periodike vjetore në vitet kalendarike 2006 – 2009 nuk ka deklaruar se ka realizuar të ardhura nga Universiteti “K.” si më poshtë vijon:

- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 subjekti ka deklaruar mësimdhënie në Fakultetin e Drejtësisë, në Fakultetin Ekonomik dhe në Universitetin “***”, gjithsej në shumën 510.000 lekë, duke mosdeklaruar të ardhura nga mësimdhënia në Universitetin “K.”, apo detyrime të këtij institucioni ndaj subjektit në rubrikën e të dhënave konfidenciale.
- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, të ardhura nga mësimdhënia, pa specifikuar institucionet publike apo private të arsimit ku është kryer kjo mësimdhënie, subjekti ka deklaruar gjithsej në shumën 320.000 lekë duke mosdeklaruar të ardhura nga mësimdhënia në Universitetin “K.”, apo detyrime të këtij institucioni ndaj subjektit në rubrikën e të dhënave konfidenciale apo detyrime të mbetura nga ky institucion arsimor ndaj subjektit në rubrikën e të dhënave konfidenciale.
- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008 subjekti ka deklaruar të ardhura nga mësimdhënia në shumën 310.000 lekë (nga “A.U.” dhe “J.P.”), duke mos deklaruar të ardhura nga mësimdhënia në Universitetin “K.”, apo detyrime të mbetura nga ky institucion arsimor ndaj subjektit në rubrikën e të dhënave konfidenciale.
- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 të ardhurat nga mësimdhënia të deklaruara nga subjekti janë në vlerën prej 450.000 lekësh dhe kjo shumë nuk përputhet me shumën e deklaruar të marrë *cash* nga subjekti në këtë vit nga Universiteti “K.” (664.200 lekë).

81.1 Në deklaratimet e viteve 2006 – 2009, subjekti ka mosdeklarime të shumës së pretenduar në vlerën 664.200 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e dyqind) lekë, tërhequr në vitin 2009 me para në dore (*cash*), dhe këto mosdeklarime të shkuara shërbejnë si provë për të përcaktuar përgjegjësinë e subjektit në raport me zbatimin e legjislacionit në fuqi.

81.2 Trupi gjykues vlerëson se në analizë të provave në tërësi me rrethanat e çështjes, dhe duke i njohur vlerën e provës, deklaratave periodike të pasurisë se vitit 2006-2009, subjekti nuk arriti të provojë të ardhurat e përfituara nga mësimdhënia për vitet 2006 – 2009 në Universitetin “K.” përfituar *cash* vitin 2009 në vlerën 664.200 lekë.

81.3 Prova e depozituar nga subjekti i rivlerësimit, me shkresën nr. ***, datë 11.1.2019, të Agjencisë të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, provon vetëm se subjekti ka qenë

parashikuar si pjesë e stafit akademik të universitetit në momentin e aplikimit për dhënie licencë të këtij të fundit pranë Ministrisë së Arsimit, por nuk provon mësimdhënien faktike në vitet 2006 – 2009 pranë këtij universiteti. Trupi gjykues vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti nuk përbën provë për të vërtetuar periudhën e plotë të punësimit të pretenduar apo masën e të ardhurave të përfituara nga ky punësim, dhe pagimin e tatimit mbi këto të ardhura.

82. Komisioni arrin në përfundimin se të ardhurat e përfituara pretenduara prej tij (marrë *cash*) nga Universiteti “K.” në vitin 2009, nuk duhen përfshirë në analizën financiare për këtë vit.

83. Analiza financiare përfundimtare për subjektin në vitin 2009 rezulton si më poshtë:

	Analiza financiare për vitin 2009	Rezultate përfundimtare
1	Të ardhurat	1,387,944
	Paga nga funksioni	972,540
	Paga e bashkëshortes	415,404
	Të ardhura nga Universiteti “K.”	
	Të ardhurat (tërheqjet nga bankat)	
2	Pasuritë	1,088,421
	Likuiditete	1,088,421
3	Detyrime	-279,975
	Kredi	0
	Shlyerje keste kredie në “Emporiki Bank”	-142,015
	Shlyerja e kredisë në euro	1,147
	Detyrim ndaj personave fizik J. Zh.	-137,960
	Dhënë hua vëllait	0
	SHPENZIME	1,124,678
	Shpenzime për qira	0
	Pagesë keste kredie “Emporiki Bank”	398,415
	Pagesë e kësteve të kredisë në euro	2,888
	Shpenzime udhëtimi	13,796
	Humbje nga kurset e këmbimit	16,180
	Shpenzime jetike	696,288
	Rezultati financiar	-1,105,131

84. Trupi gjykues arriti në përfundimin se për vitin 2009 me të ardhurat e ligjshme - për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, sipas përcaktimit të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës - subjekti nuk ka pasur mundësi për të shlyer keestet e kredive bankare, për të përballuar shpenzimet jetike dhe për të kursyer likuiditetet dhe krijuar gjendje në llogaritë bankare, dhe për shpenzime të tjera, duke rezultuar me një bilanc negativ prej – 1.105.131 lekë.

IV/b Në lidhje me pamjaftueshmërinë financiare në vitin 2011

85. Për vitin 2011 pas kryerjes së analizës financiare për subjektin e rivlerësimit për vitin 2011 ka rezultuar se të ardhurat e ligjshme, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, nuk janë të mjaftueshme për të shtuar gjendjen e likuiditeteve në fund të vitit në llogaritë bankare, duke sjellë për subjektin një bilanc negativ në vlerën – 4.536.201.

86. Nga analiza e deklaratës “Vetting” në raport me deklaratimet ndër vite të administruara në dosjen e ILDKPKI-së dhe dokumentacionit siguruar nga Komisioni nëpërmjet hetimit administrativ, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, dhe në paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime dhe prova të tjera për të provuar të kundërtën për pamjaftueshmërinë financiare në vitin 2011.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

87. Pas kalimit të barrës së provës me shpjegimet dhe provat e protokolluara në Komision me nr. *** prot., datë 10.6.2019, subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, shpjegoi sa më poshtë:

87.1 “Nuk keni përfshirë në raport të ardhurat e siguruar nga udhëheqjet e diplomave në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin K., në vlerën 400.000 (katërqind mijë) lekë, të tërhequra në fundin e muajit maj të vitit 2011 në financën e Universitetit K., të pasqyruara në vërtetimin e datës 25.7.2011, fakt të cilin e kam pasqyruar edhe në deklarin periodik të pasurisë të vitit 2011, si dhe kam sqaruar në lidhje me këtë fakt edhe në përgjigjet e pyetësorit tuaj të cilin e kam dërguar në datën 30.1.2019. Në vërtetimin e datës 25.7.2011 të Universitetit K. pasqyrohen të ardhurat e marra për vitin 2011 nga udhëheqja e diplomave të marra në muajin maj të vitit 2011, si dhe të ardhurat nga mësimdhënia në “Union Bank” nga Universiteti K., në datën 11.7.2011.

87.2 Në lidhje me faktin e udhëheqjes së diplomave të studentëve të vitit të dytë master në të Drejtën Civile, përveç vërtetimit të mësipërm, kam paraqitur edhe deklaratat noteriale të disa studentëve të këtij fakulteti, që i kam udhëhequr në diplomë, të cilët kam mundur t’i gjej dhe konkretisht: M.M., O.K., S.M., P.Gj., si dhe një deklaratë noteriale të ish-dekanit të Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit K. në këtë periudhurë, Prof. Asc. Dr. A.Ll., deklaratat të cilat po jua vë në dispozicion.

87.3 Për të evidentuar studentët që kam udhëhequr në programin master në vitin 2011 në Universitetin K., i jam drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresën e datës 22.5.2019, ku i kam kërkuar informacion në lidhje me këtë fakt, për shkak se Universiteti K. është mbyllur në vitin 2014, sipas VKM-së nr. 539, datë 6.8.2014, dhe dokumentacioni i këtij universiteti ndodhet në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

87.4 Në përgjigjen që më ka dërguar Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me shkresën nr. ***, datë 31.5.2019, rezulton se kjo ministri nuk disponon asnjë informacion në lidhje me dokumentacionin e personelit akademik të Universitetit K., ku i vetmi dokumentacion i është regjistri i matrikullimit të studentëve.

87.5 Mendoj se këto të adhura janë të ligjshme dhe ky fakt është vërtetuar nga Universiteti K. me vërtetimin e lëshuar në datën 25.7.2011. Ky universitet është krijuar dhe ka vazhduar funksionimin e tij mbi bazën e një licence të dhënë nga organi kompetent. Ruajta e dokumentacionit financiar të tij, nuk është detyrim i imi por i institucioneve të këtij shteti. Vlera prej 400.000 (katërqind mijë) lekësh është përfshirë në depozitën 10.300 (dhjetë mijë e treqind) euro.

87.6 Evidentoj para jush faktin se në datën 21.3.2011 ka ndërruar jetë nëna ime N.M., në moshën 60 vjeçare, fakt të cilin e pasqyroj me certifikatën e vdekjes me nr. ***, datë 27.5.2019, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative Nr. ***, Tiranë. Për shkak të këtij fakti të njohur nga të gjithë, në banesën time të ndodhur në Rr. ‘***’, p. ***, kanë ardhur kolegë, miq, shokë dhe të afërm, duke respektuar të drejtën zakonore shqiptare në raste të tilla, për këtë ngjarje më është mbledhur një vlerë në të holla prej 600.000 (gjashtëqind mijë) lekësh, vlerë e cila është përfshirë në depozitën 10.300 (dhjetë mijë e treqind) euro. Shumën e mësipërme nuk e kam deklaruar për shkak të ndjeshmërisë së faktit”.

87.7 Pas kalimit të barrës së provës me shpjegimet e protokolluara me nr. ***, datë 10.6.2019, në Komision, subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, bashkëlidhi akt-ekspertimin kontabël të datës 7.6.2019, nga audituesi kontabël z. B.P., në të cilin eksperti kontabël, ka bërë një raport financiar në lidhje me gjendjen financiare të subjektit për vitin 2011.

Arsyetime ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

88. Trupi gjykues analizoi provat e hetimit administrativ, shpjegimet dhe provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, dhe akt-ekspertimin e datës 7 qershor 2019, nga ekspert

kontabël i regjistruar, z. B.P., në të cilin është bërë raport financiar në lidhje me gjendjen financiare të tij për vitin 2011, e bazuar në provat dhe faktet e analizuara së bashku, arsyeton se:

89. Akteksptimi kontabël i datës 7.6.2019, ka marrë në analizë financiare pagesën si udhëheqës i diplomave në Universitetin “K.”, në shumën 400.000 lekë, për të cilat subjekti paraqiti si provë deklaratat noteriale të disa studentëve të këtij fakulteti, që i ka udhëhequr në diplome.

89.1 Trupi gjykues i dha deklaratës periodike vjetore 2011 të subjektit vlerën e provës në referim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, dhe sipas nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile, dhe duke e çmuar me rëndësi provuese për pasurinë objekt kontrolli, së bashku me provat e tjera, deklarimin e këtyre të ardhurave për pagesën si udhëheqës i diplomave në Universitetin “K.”, në shumën 400.000 lekë, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011.

89.2 Në analizë të provave gjatë hetimit administrativ, shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, së bashku me provat e tjera në tërësi me rrethanat e çështjes, trupi gjykues vlerëson se subjekti arriti të provojë të ardhurat e përfituara nga udhëheqja e diplomave në Universitetin “K.” në vlerën 400.00 lekë (*cash*) në vitin 2011.

90. Akt-kspertimi kontabël i datës 7.6.2019 ka marrë në analizë financiare grumbullimin e shumës 600.000 lekë nga të afërmit, miqtë dhe kolegët për fatkeqësinë e humbjes së të ndieres nënës së tij, si të ardhura për subjektin.

91. Subjekti nuk i ka deklaruar këto të ardhura në deklaratën “Vetting” dhe në as në deklarimin periodik vjetor të vitit 2011, dhe i dha deklaratës periodike vjetore 2011 të subjektit vlerën e provës në referim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, dhe sipas nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile, dhe duke e çmuar me rëndësi provuese për pasurinë objekt kontrolli, së bashku me provat e tjera, mosdeklarimi shumës së pretenduar shërben si provë për të përcaktuar përgjegjësinë e subjektit në raport me zbatimin e legjislacionit në fuqi, keto të ardhura nuk u morën në konsideratë në analizën financiare të kryer për këtë vit nga Komisioni.

92. Akt-kspertimi kontabël i datës 7.6.2019, ka marrë në analizë financiare të ardhura të realizuara nga tërheqja *cash* e shumës 30.000 euro nga shoqëria “***” sh.p.k., të konvertuar në vlerën 4.284.300 lekë. Trupi gjykues vlerëson se këto të ardhura duhet të merren në konsideratë në analizë financiare, për sa kohë subjekti i ka deklaruar këto të ardhura në deklaratën “Vetting” dhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, si dhe provoi burimin e ligjshëm të krijimit të tyre, siç është arsyetuar nga pika 73.8 deri në pikën 73.11 të këtij vendimi.

93. Në analizën financiare të ekspertit kontabël nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat e realizuara në këtë vit nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, por është bazuar në tërheqjet e kryera nga subjekti dhe bashkëshortja e tij nga bankat. Trupi gjykues vlerëson se analiza financiare duhet të bazohet në të ardhurat e bashkëshortëve dhe jo në tërheqjet bankare, të cilat jo gjithmonë pasqyrojnë të ardhurat e tyre, edhe në analizën financiare të Komisionit të ardhurat duhet të merren referuar të ardhurave të dokumentuara të bashkëshortëve.

94. Në analizë të provave gjatë hetimit administrativ dhe pas shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, trupi gjykues arriti në përfundimin se për vitin 2011 me të ardhurat e ligjshme - për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, sipas përcaktimit të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës - subjekti ka pasur mundësi për të shlyer këstet e kredive bankare, për të përballuar shpenzimet jetike dhe për të kursyer likuiditetet dhe krijuar gjendje në llogaritë bankare, dhe për shpenzime të tjera, duke rezultuar me një bilanc pozitiv në vlerën 148.100 lekë.

IV/c Në lidhje me pamjaftueshmërinë financiare në datën 10.6.2011

95. Në datën 10.6.2011, në llogarinë bankare nr. *** në euro, në “Emporiki Bank”, subjekti ka depozituar *cash* shumën 10.300 euro, duke e vendosur këtë shumë depozitë. Në analizën

financiare kjo shumë është llogaritur 1.470.943 lekë, referuar kursit të këmbimit valutor (142.81 lekë/euro, marrë nga Banka e Shqipërisë).

96. Bazuar në analizën financiare të kryer nga Komisioni deri në datën 10.6.2011, ditë kur është kryer veprimi financiar i depozitimit në “Emporiki Bank”, subjekti ka pasur pamjaftueshmëri financiare për të shlyer këstet e kredive bankare, për të përballuar shpenzimet minimale jetike dhe për të kursyer likuiditete, dhe krijuar gjendje cash në shumën 10.300 euro, depozituar në bankë në datën 10.6.2011, duke rezultuar me një bilanc negativ prej -1.470.885 lekësh.

97. Nga analiza e deklaratës “Vetting” në raport me deklaratimet ndër vite të administruara në dosjen e ILDKPKI-së dhe dokumentacionit siguruar nga Komisioni nëpërmjet hetimit administrativ, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, dhe në paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime dhe prova të tjera për të provuar të kundërtën për pamjaftueshmërinë financiare për periudhën 1.1.2011 – 10.6.2011.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

98. Pas kalimit të barrës së provës me shpjegimet dhe provat e protokolluara në Komision me nr. *** prot., datë 10.6.2019, subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, shpjegoi sa më poshtë:

98.1 “Në analizën financiare për vitin 2011 (1.1.2011 – 31.12.2011), ju keni arritur në përfundimin se nuk kam pasur mundësi financiare të ligjshme për të shlyer këstin e fundit të kredisë bankare, duke rezultuar me rezultat financiar negativ në shumën 4. 536. 201 lekë. Po sipas përfundimeve tuaja keni arritur në konkluzionin se unë nuk kam paguar tatim për shumën 30.000 euro dhe ajo nuk mund të konsiderohet si e ardhur e ligjshme.

98.2 Në lidhje me rezultatin financiar të vitit 2011, sqaroj se: sipas tabelës së përpiluar prej jush, gjithë shpenzimet janë në masën 5.903.898 lekë, përkatësisht 546.480 lekë, shpenzime jetese, 534.110 humbje nga kurset e këmbimit, 265.356 lekë shpenzime udhëtimi, 171.381 lekë pagim kësti kredie në “Emporiki Bank”, duke i shtuar shpenzimeve edhe vlerën shlyerje kredie 35.418 euro e konvertuar në vlerën 4.389.571 lekë, në total gjithë vlera e shpenzimeve është në masën 5.903.898 lekë.

98.3 Në lidhje me vitin 2011 kam tërhequr nga banka vlerën 1.540.396 lekë. Gjatë këtij vitit kam përfutuar vlerën 400.000 lekë, në maj të vitit 2011 nga mbrojtja e diplomave në Universitetin K. Po kështu, gjatë vitit 2011 kam pasur gjendje shumën 600.000 lekë për shkak të fatkeqësisë familjare të vdekjes së nënës sime. Po kështu, në muajt qershor – korrik të vitit 2011, kam përfutuar shumën 30.000 (tridhjetë mijë) euro, për efekt të ndërtimit të bërë në pronën e familjes, e konvertuar në vlerën 4.284.300 (katër milionë e dyqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind) lekë, si pasuri trashëgimore e ardhur nga nëna ime, e cili ka ndërruar jetë në datën 21.3.2011 (trashëgimtar ligjor i radhës së parë për 1/4 pjesë), bazuar në dëshminë e trashëgimisë ligjore nr. 9228/3669, datë 29.12.2018”.

98.4 Pas kalimit të barrës së provës me shpjegimet e protokolluara me nr. ***, datë 10.6.2019, në Komision, subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, bashkëlidhi akt-ekspertimin kontabël të datës 7.6.2019 nga auditues z. B.P. në të cilin eksperti kontabël, ka bërë një raport financiar mbi gjendjen financiare të subjektit për periudhën 1.1.2011 – deri më 10.6.2011.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

99. Trupi gjykues analizoi provat e hetimit administrativ, shpjegimet dhe provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, akt-ekspertimin e datës 7 qershor 2019, nga ekspert kontabël i regjistruar, z. B.P., në të cilin është bërë raport financiar në lidhje me gjendjen

financiare të subjektit për periudhën 1.1.2011 – 10.6.2011, deklarimet periodike të subjektit për vitet 2010 dhe 2011, bazuar në provat dhe faktet e analizuara së bashku, arsyeton se:

100. Për periudhën 1.1.2011 – 10.6.2011 eksperti kontabël ka llogaritur të ardhura në shumën 719.000 lekë sipas tërheqjeve bankare nga subjekti dhe bashkëshortja.

101. Trupi gjykues vlereson se analiza financiare duhet të bazohet në të ardhurat e bashkëshortëve dhe jo në tërheqjet bankare, të cilat jo gjithmonë pasqyrojnë të ardhurat e tyre, ndaj në analizën financiare të Komisionit të ardhurat për periudhën 1.1.2011 – 10.6.2011 janë marrë në shumën 900.973 lekë, referuar të ardhurave të dokumentuara të bashkëshortëve.

102. Akt-ekspertimi kontabël i datës 7.6.2019, nuk ka llogaritur si shpenzim të kësaj periudhe pagesën e këstit të principalit të kredisë bankare, në shumën 1.460 euro,(202.838 lekë), duke llogaritur vetëm interesin dhe duke bërë një përlllogaritje jo të saktë të këtij detyrimi të subjektit.

103. Akt-ekspertimi kontabël i datës 7.6.2019 ka marrë në analizë financiare grumbullimin e shumës prej 600.000 lekësh nga të afërmit, miqtë dhe kolegët për fatkeqësinë e humbjes së nënës, trupi gjykues, për të cilat është arsyetuar në pikën 91 të këtij vendimi.

104. Akt-ekspertimi kontabël i datës 7.6.2019 nuk ka marrë në konsiderate shitesën e gjendjes së likuiditeteve në bankë në datën 10.6.2011, llogaritur si diferencë midis gjendjes në këtë datë me gjendjen në datën 1.1.2011, për shumën 1.932.020 lekë, sipas tabelës së mëposhtme:

Gjendja e llogarive bankare në fillim të vitit 2011 dhe në datën 10.6.2011

Ilir Mustafaj	Nr. llog. bankare	1 janar 2011	10.6.2011	Shtesa/pakësime
“Raiffeisen Bank”	***	310,468	-151	-310,619
BKT	***	0	0	0
“Union Bank”	***	272,010	624,686	352,676
“Emporiki Bank” euro	***	248	(10 300 Euro) 1,470,943	1,470,695
“Credins Bank”	***	130,487	429,044	298,557
Bashkëshortja				
“Raiffeisen Bank”	***	84,406	204,950.4	120,544
E bija, I.				
“ProCredit Bank”	***	5,556	5,723	167
TOTALE		803,175	2,735,195	1,932,020

105. Analiza financiare përfundimtare për subjektin për vitin 2011 rezulton si më poshtë:

Nr.	Analiza financiare 10.6.2011	Rezultate hetimi	Rezultate përfundimtare
Pasuritë		1,932,020	1,932,020
	Likuiditete	1,932,020	
DETYRIME		-202,838	-202,838
	Shlyerje këst kredie	-202,838	-202,838
TË ARDHURA		900,973	1,300,973
	Paga e subjektit	679,458	679,458

	Paga e bashkëshortes	221,515	221,515
	Të ardhurat nga tërheqjet nga bankat		
	Udhëheqje diplomash “K.”		400,000
	Nga humbja e te ndieres nënës se tij		
SHPENZIME		237,000	237,000
	Shpenzime jetike	237,000	237,000
5	Rezultati financiar 10.6.2011	-1,470,885	-1,070,885

106. Trupi gjykues arrin në përfundimin se me të ardhurat e ligjshme, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore deri në datën 10.6.2011, sipas përcaktimit të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjekti nuk ka pasur mundësi për të shlyer këstet e kredive bankare për të përballuar shpenzimet jetike dhe për të kursyer likuiditete *cash* ose në llogaritë bankare, si dhe për shpenzime të tjera, duke rezultuar me një bilanc negativ në vlerën – **1.070.885** lekë.

IV/d Në lidhje me pamjaftueshmërinë financiare në vitin 2013

107. Për vitin 2013 pas kryerjes së analizës financiare ka rezultuar se të ardhurat e ligjshme, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, nuk janë të mjaftueshme për të shtuar gjendjen e likuiditeteve në fund të vitit në llogaritë bankare, duke sjellë për subjektin një bilanc negativ në shumën - 463,857 lekë.

Nga analiza e deklaratës “Vetting” në raport me deklaratimet ndër vite të administruara në dosjen e ILDKPKI-së dhe dokumentacionit siguruar nga Komisioni nëpërmjet hetimit administrativ, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, dhe në paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime dhe prova të tjera për të provuar të kundërtën për pamjaftueshmërinë financiare për vitin 2013.

108. Pas kalimit të barrës së provës, me shpjegimet dhe provat e protokolluara me nr. ***, datë 10.6.2019, në Komision, subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, bashkëlidhi akt ekspertimin kontabël të datës 7.6.2019, nga auditues kontabël i regjistruar, z. B.P., në lidhje me gjendjen financiare të subjektit për vitin 2013.

109. Trupi gjykues analizoi provat e hetimit administrativ, shpjegimet dhe provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, akt-ekspertimin e datës 7 qershor 2019, nga ekspert kontabël i regjistruar, z. B.P., në të cilin është bërë raport financiar në lidhje me gjendjen financiare të tij për vitin 2013, deklaratimet periodike vjetore të subjektit për vitet 2012 dhe 2013 dhe bazuar në provat dhe faktet e analizuar së bashku, arsyeton se:

- Akt-ekspertimi kontabël i datës 7.6.2019 për vitin 2013 nuk ka marrë në konsideratë të ardhurat e realizuar në këtë vit nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja, por është bazuar në tërheqjet e kryera nga banka. Trupi gjykues vlerëson se analiza financiare duhet të bazohet në të ardhurat e bashkëshortëve dhe jo në tërheqjet bankare, të cilat jo gjithmonë pasqyrojnë të ardhurat e tyre.
- Akt-ekspertimi kontabël i datës 7.6.2019, për vitin 2013 nuk ka marrë në konsideratë shtesën e gjendjes së likuiditeteve në bankë në fund të vitit 2013, sipas tabelës së mëposhtme. Trupi gjykues vlerëson se analiza financiare duhet të llogarisi edhe keto likuiditete.

Gjendja e llogarive bankare në fillim të vitit dhe në fund të vitit 2013

Ilir Mustafaj		Në fillim të vitit 2013	Në fund të vitit 2013
“Raiffeisen Bank”	***	54,101	189,107
“Union Bank”	***	193,030	131,125
	Depozitë me afat	3,650,000	2,500,000
“NBG”	***	133,600	589,588
“Credins Bank”	***	149,589	200,646
	Depozitë në lekë	0	3,000,000
“Raiffeisen Bank” (bashkeshortja)	***	62,941	60,048
“ProCredit Bank”	***	5,894	6,114
“Credins Bank”	***	9,000	27,000
	TOTALE	4,258,159	6,703,628
Shtesë në gjendjen e llogarive bankare			2,445,469

110. Analiza financiare përfundimtare për subjektin për vitin 2013 rezulton si më poshtë::

	Analiza financiare viti 2013	Rezultate përfundimtare
1	Të ardhurat	3,151,965
	Paga nga funksioni	2,380,538
	Paga e bashkëshortes	675,182
	Të ardhura nga interesat “Union Bank”	96,245
2	Pasuritë	2,445,469
	Likuiditete	2,445,469
SHPENZIME		1,170,353
	Shpenzime shkollimi të djalit	126,189
	Shpenzime udhëtimi	162,644
	Shpenzime jetike	881,520
	Rezultati financiar	-463,857

111. Trupi gjykues arriti në përfundimin se me të ardhurat e ligjshme, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore për vitin 2013, sipas përcaktimit të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjekti nuk ka pasur mundësi për të shlyer këstet e kredive bankare për të përballuar shpenzimet jetike dhe shpenzime të tjera dhe për të kursyer likuiditete në llogaritë bankare, duke rezultuar me një bilanc negativ në vlerën - 463,857 leke.

112. Në përfundim të analizës financiare të kryer për subjektin e rivleresimit, trupi gjykues arriti në përfundimin se me të ardhurat e ligjshme, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore sipas

përcaktimit të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjekti nuk ka pasur mundësi për të shlyer këstet e kredive bankare për të përballuar shpenzimet jetike dhe për të krijuar likuiditete në llogaritë bankare, dhe shpenzime të tjera, duke rezultuar me një bilanc negativ për vitin 2009 në vlerën -1.105.131 lekë; për periudhën 1.1.2011 – 10.6.2011 në vlerën -1.070.885 lekë; dhe për vitin 2013 në vlerën - 463,857 lekë , duke rezultuar me një bilanc negativ **në total -2.639.867 lekësh.**

V. Pasuria e personave të tjerë të lidhur

113. Në përputhje me Aneksin e Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni kreu hetim për babanë e subjektit, z. B.M. dhe për të vëllanë, z. A.M., pasi ata u konsideruan si persona të tjerë të lidhur, në kuptim të pikës 14, të nenit 3.

114. Komisioni kreu hetim të thelluar për këtë pasuri të personave të tjerë të lidhur pasi nga kjo pasuri subjekti kishte përfituar vlerën 30.000 euro dhe referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2011 do të përfitonte në të ardhmen edhe sipërfaqe ndërtimore, nga e cila ai hoqi dorë në vitin 2016.

115. Shkresa nr. ***, datë 26.9.2018, e shoqërisë “***” sh.p.k., informon se nga familja Mustafaj, është përfituar si më poshtë:

- njësi tregtare me sip. 50 m²;
- apartamente me sip. totale 716.5 m²;
- sip. e shkëmbyer 50 m² (30.000 euro);
- sip. e përbashkët 123.3 m²;
- verandë me sip. 154.9 m²;
- dhënë N.P. (vjehri) sip. 33.4 m²;
- blerë nga shoqëria (zbritur nga sip.) - 35.9 m² .

Totali i sipërfaqes 1092.2 m²

116. Duke marrë në konsideratë të gjitha sipërfaqet e përfituara, sipërmarrësi i ka dhënë gati 105 % të ndërtimit si kompensim familjes Mustafaj. Nëse nga sipërfaqja e përfituar (1092.2 m²) zbritet sip. 154.9 m² verandë si kamatvonesë ndërtimi dhe sip. 150 m² nga kompensimi i ndërtesës dykatëshe, familja Mustafaj ka përfituar 787 m², ose 76 % të ndërtimit si kompensim.

117. Nga analiza e deklaratës “Vetting” në raport me deklaratimet ndër vite të administruara në dosjen e ILDKPKI-së dhe dokumentacionit siguruar nga Komisioni nëpërmjet hetimit administrativ, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, dhe në paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime dhe prova të tjera për të provuar të kundërtën për dyshime mbi besueshmërinë e deklaratimit mbi burimet e krijimit të apartamentit të banimit me sipërfaqe 121 m² në rrugën “***” dhe për sa marrë në shkëmbim personat e tjerë të lidhur me subjektin sipërfaqje 787 m² ose e llogaritur në përqindje 76 % si kompensim të ndërtimit mbi pronen e tyre, ndryshe nga pronarët e tjerë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

118. Pas kalimit të barrës së provës me shpjegimet dhe provat e protokolluara në Komision me nr. *** prot., datë 10.6.2019, subjekti i rivlerësimit, ka sqaruar se:

119. Kur është lidhur kontrata e sipërmarrjes, përveç sip. truall 332 m², që figuronte e regjistruar në emër të z. A.M., mbi këtë truall ekzistonte edhe ndërtesa funksionale me sip. 300 m², prandaj dhe kontrata e sipërmarrjes është nënshkruar nga shtetasit A. dhe B.M., si palë me të drejta reale pronësie mbi pasurinë e paluajtshme truall-ndërtesë, me sip. totale 632 m².

120. Marrëdhënia e krijuar midis shoqërisë ndërtuese nga njëra anë, dhe babait dhe vëllait nga ana tjetër, është marrëdhënie juridiko-civile e udhëhequr nga vullneti i këtyre palëve, vullnet ky i formalizuar në kontratën e sipërmarrjes në vitin 2011, dhe në vijim, në kontratën e shkëmbimit në vitin 2018.

121. Si në çdo marrëdhënie juridiko-civile palët kanë pasur lirinë të negociojnë lidhur me të gjitha kushtet e kontratës, ndër to edhe për përqindjen e sipërfaqeve që do të përfitonte çdo pronar i truallit mbi të cilin do të realizohej ndërtimi.

122. Ai shpjegoi se nuk ka pasur asnjë marrëdhënie shtetërore apo private të shkaktuar nga marrëdhënia e punës apo lidhje jashtë saj që të mundësonin favorizimin e familjareve lidhur me pjesën takuese të tyre, dhe ka qenë krejt indiferent dhe me vetëdije të plotë jashtë kësaj marrëdhënieje.

V/b Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

123. Trupi gjykues analizoi provat e hetimit administrativ, shpjegimet dhe provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit, dhe bazuar në provat dhe faktet e analizuara së bashku, arsyeton se procedura e kontrollit të pasurive të personave të lidhur synon identifikimin e subjekteve të rivlerësimit, të cilët janë bërë përfitues apo përdorues të pasurive në mënyrë të paligjshme, ligjshmëria e të cilave vihet në dyshim

124. Pretendimi i subjektit se nuk është marrë në konsideratë sipërfaqja e përfituar për shtëpinë e palegalizuar nuk qëndron, sepse në llogaritjet e përqindjeve të bëra nga Komisioni është zbritur efekti i sipërfaqes 150 m² përfituar për ndërtesën.

124. Trupi gjykues, vlerëson se subjekti duhet të tregonte kujdes të shtuar dhe të mos ishte indiferent dhe me vetëdije të plotë jashtë një marrëdhënie të familjarëve të tij me firmën e ndërtimit, sikundër ka deklaruar, për sa kohë ai përfitoi vlerën 30.000 euro nga kjo marrëdhënie, dhe do të përfitonte në të ardhmen, edhe sipërfaqe ndërtimore nga kjo marrëdhënie.

125. Trupi gjykues arrin në përfundimin se në referencë të parashikimeve ligjore, në provat që disponon Komisioni, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive të personave të tjerë të lidhur, sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk arriti t'i shpjegojë bindshëm arsyet e tërheqjes së tij në vitin 2016 nga përfitimi i sipërfaqes ndërtimore deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011.

VI. Automjet tip “Mercedes Benz”

126. Sipas dokumentacionit të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ automjeti tip “Mercedes Benz” është blerë nga subjekti i rivlerësimit në datën 12.11.2003, për shumën 1.500 euro. Bazuar në deklaratën doganore import të datës 19.11.2003, detyrimet doganore janë paguar në shumën 151.212 lekë.

127. Me kontratën e shitjes së pasurisë nr. ***, datë 19.1.2004, subjekti ia shet këtë automjet bashkëshortes së tij kundrejt vlerës 500.000 lekë.

128.Për sa më sipër, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektivit që të provojë të kundërtën, për sa në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004 subjekti nuk ka deklaruar kalimin e pronësisë së mjetit të bashkëshortja, si dhe për faktin se nuk del i qartë shkaku i shitjes së këtij mjeti bashkëshortes, pasi deklarohet në bashkëpronësi me të 50/50.

Qëndrimi i subjektivit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

129.Pas kalimit të barrës së provës me shpjegimet dhe provat e protokolluara në Komision me nr. *** prot., datë 10.6.2019, subjekti i rivlerësimit, ka sqaruar se

129.1 Duke qënë pasuri bashkëshortore, unë nuk e kam pasqyruar këtë fakt në deklarin e pasurisë të vitit 2004, pasi ishte i deklaruar nga ana ime ne vitin 2003 dhe nuk përbënte asnjë shtim në pasurinë tonë. Qënien e automjetit në bashkëpronësi bashkëshortore e kam pasqyruar në deklaratën Vetting. Këtë fakt e ka pranuar edhe bashkëshortja me nënshkrimin e deklaratave periodike dhe deklaratën "Vetting".

129. Vlera e shitjes së automjetit nga ai tek bashkeshortja është vlerë e caktuar pa kujdes, nën sensin që asgjë nuk do të ndryshonte në pronësinë e tij. Vlera caktuar thjesht element i domosdoshem i kontratës së shitjes, që të bëhej rregjistrimi i ri i mjetit.

130. Trupi gjykues vlerëson se nepermjet këtij transaksioni shitje automjeti nga subjekti të bashkëshortja ne te kundert te sa deklarom subjekti ishin krijuar likuiditete te cilat duhet te pasqyroheshin në deklaratën “Vetting”dhe në deklarimin e pasurisë të vitit 2004 nga subjekti sipas detyrimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

Subjekti nuk arriti të shpjegojë se përse bashkëshortja bleu edhe pjesën takuese të saj ne këtë automjet dhe për më tepër me një vlerë disa here më të lartë, se vlera e blerjes, duke mos arritur të shpjegojë bindshem burimin e ligjshem te krijimit te kesaj pasurie si pasuri e deklaruar në deklaratën “Vetting” nga personi i lidhur bashkeshortja e tij.

Ne konkluzion për vlerësimin e pasurisë, trupi gjykues arrin në përfundimin se :

- i) me të ardhurat e ligjshme, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore sipas përcaktimit të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjekti rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj nuk ka pasur mundësi për të shlyer këstet e kredive bankare, për të përballuar shpenzimet jetike dhe shpenzime të tjera dhe për të kursyer likuiditete në llogaritë bankare, duke rezultuar me një bilanc negativ për vitin 2009 në vlerën -1.105.131 lekë; për periudhën 1.1.2011 – 10.6.2011 në vlerën -1.070.885 lekë; dhe për vitin 2013 në vlerën - 463,857 lekë , në total me një bilanc negativ **në total -2.639.867 lekësh.**
- ii) subjekti rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë së tij dhe te personave te lidhur sipas parashikimeve te paragrafit 1 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.
- iii) subjekti rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimin e relatores të çështjes, zhvilloi seancën dëgjimore publike, mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, arrin në përfundimin se bazuar në paragrafin 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë.

PËR KËTO ARSYE

Trupi gjykues, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet A, Ç, D, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Ilir Mustafaj, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë **18.07.2019**.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Kryesues
Lulzim Hamitaj

Relatore
Xhensila PINE

Anëtare
Valbona SANXHAKTARI

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj